

Raport i Rregullt Ekonomik
për
Evropën Juglindore

Nr. 7

PËRBALLIMI I
PËRMBYTJEVE,
FORCIMI I RRITJES

janar, 2015

Falënderim

Ky Raport i Rregullt Ekonomik (RRrE) mbulon zhvillimet ekonomike, perspektivat dhe politikat në gjashtë shtetet e Evropës Juglindore (SJC6), përkatësisht në: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi.

Raporti përgatitet dy herë në vit nga stafi i ekonomistëve të Bankës Botërore që punojnë për Ballkanin Perëndimor. Skuadra e autorëve përfshin Gallina A Vincelette (drejtuese e grupit të punës dhe autore kryesore e raportit), Anil Onal (autor kryesor), Simon Davies (autor kryesor), Abebe Adugna, Agim Demukaj, Doerte Doemeland, Sandra Hlivnjak, Johanna Jaeger, Suzana Petrovic, Lazar Sestović, Sanja Madzarević-Sujster, Hilda Shijaku dhe Bojan Shimbov. Mizuho Kida, Anna Ragl, Erika Jorgensen, Joaquin Toro, Fernanda Serna de Moura kanë dhënë kontributin e tyre lidhur me zhvillimet dhe gjendjen globale, ndikimin global ekonomik të ndryshimeve klimaterike, ndikimin ekonomik të situatës tronditëse mjedisore në gjashtë shtetet e Evropës Juglindore. Budy Wirasmo ka ndihmuar në projektimin e këtij raporti. Dragana Varezić dhe Nejme Kotere kanë dhënë mbështetje për skuadrën.

Shpërndarja e raportit dhe marrëdhëniet me publikun dhe me median janë menaxhuar nga skuadra e EXR-së, e përbërë nga Lundrim Aliu, Boris Balabanov, Anita Bozinovska, Ana Gjokutaj, Jasmina Hadzić, Andrew Kircher, Vesna Kostić, Mirjana Popovć, John Mackedon, dhe Kristyn Schrader-King.

Skuadra i është mirënjohëse Ellen Goldstein-it (Drejtoreshë për Vendet në Departamentin e Evropës Juglindore), Satu Kähkönen-it (Drejtor, Praktika Globale e Menaxhimit Makroekonomik dhe Fiskal), Ivailo Izvorski-t (Menaxher Praktikë, Praktika Globale e Menaxhimit Makroekonomik dhe Fiskal), dhe Njësisë së Menaxhimit të Evropës Juglindore për udhëzimet dhe për përgatitjen e këtij raporti. Skuadra është mirënjohëse po ashtu për komentet e marra për draftet paraprake të këtij raporti nga Bankat Qendrore dhe Ministritë e Financave të shteteve të sipërpërmendura.

Ky raport si dhe raportet e mëparshme të RRrE-së për Evropën Juglindore mund të gjenden në adresën: www.worldbank.org/eca

Deklaratë standarde për heqjen dorë nga përgjegjësia

Ky botim është produkt i stafit të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore, ose të qeverive që ata përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë raport. Kufijtë, ngjyrat, përcaktimet ose informacionet e tjera të përfshira në çdonjërin ndër hartat në këtë dokument nuk nënkuptojnë asnjë interpretim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori, ose miratimin apo pranimin e këtyre kufijve.

E drejta e autorit

Materiali në këtë botim është i mbrojtur nga e drejta e autorit. E drejta e autorit dhe/ose marrja e fragmenteve ose e të gjithë punës pa leje paraprake mund të përbëjë shkelje të ligjit të zbatueshëm. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe normalisht jep leje për riprodhimin e pjesëve të raportit menjëherë. Për leje për të bërë fotokopje, ose për të riprintuar pjesë të kësaj pune, ju lutem na dërgoni një

kërkesë me informacion të plotë në adresën: Clearance Center, Inc., 222 Rosewood Drive, Danvers, MA 01923, USA, telefon 978-750-8400, faks 978-750-4470, <http://www.copyright.com/>. Të gjitha pyetjet lidhur me të drejtat dhe licencat, përfshirë dhe të drejtat e prejdardhura, duhet të drejtohen në adresën: Office of the Publisher, The World Bank, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA, fax 202-522-2422, e-mail pubrights@worldbank.org.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE	i
Zhvillimet e fundit.....	i
Parashikimi për 2015-ën.....	iii
I. ZHVILLIMET E EKONOMISE REALE	1
Sektori real	1
Tregtia me jashtë dhe sektori i jashtëm.....	8
Tregu i punës.....	15
Financat dhe borxhi publik	19
Inflacioni, politikat monetare dhe të shkëmbimit valutor	25
Sektori financiar.....	28
II. PERSPEKTIVAT	36
MOMENTI I RËNDËSISHËM I. NDIKIMI EKONOMIK I NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE NË EJL6 DHE MËSIMET E NXJERRA NGA STUDIMI I RRITJES SË GJELBËRT NË ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË	42
MOMENT I RËNDËSISHËM II. ANALIZË E MIGRACIONIT NË EJL6.....	47
Shtojca: Treguesit makroekonomikë	53

PËRMBLEDHJE

Zhvillimet e fundit

Ekonomia e Evropës Juglindore (EJL6) vlerësohet të ketë qëndruar në vend në vitin 2014 për shkak të kontraktimit të ekonomisë në Serbi¹. Ekonomia rajonale pritet të jetë rritur vetëm me 0.2 përqind në vitin 2014, rritje kjo e pamjaftueshme për të përmirësuar standardet e jetesës dhe për të lënë gjurmë në nivelin e lartë të papunësinë në rajon. Kërkesa e jashtme për eksportet e EJL6-ës ishte kontribuesi kryesor pozitiv për rritjen ekonomike në vitin 2014, pavarësisht nga performanca e dobët e Eurozonës dhe rimëkëmbja zhgënjyese globale. Kërkesa e brendshme mbeti e dobët për shkak të vonesave ose të shkurtimeve të investimeve publike dhe private dhe konsumit të dobët. Situatat shokuese të motit të keq ushtruan presion të shtuar mbi aktivitetin ekonomik të EJL6-ën në vitin 2014.

Rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) në Evropën Juglindore, 2013-15

	2013	2014e	2015f
ALB	1.4	2.1	3.0
BIH	2.5	0.4	1.5
KOS	3.4	2.5	3.0
MKD	2.7	3.3	3.5
MNE	3.3	1.5	3.4
SRB	2.6	-2.0	-0.5
EJL6	2.5	0.2	1.3
Eurozona	-0.4	0.8	1.1

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe parashikimet e Bankës Botërore.

Shënim: EJL6-a është mesatare e ponderuar.

Performanca e dobët ekonomike rajonale fsheh dasi të dukshme ndërmjet shteteve të EJL6-ës. Në vitin 2014, ekonomia serbe vlerësohet të jetë tkurrur me 2 përqind, për të tretën herë që prej krizës globale, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina është në stanjacion. Nivelet e rritjes ekonomike në Kosovë dhe në Mal të Zi vlerësohen të kenë rënë në vitin 2014. Vetëm Shqipëria dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë treguar shenja rimëkëmbje më të qëndrueshme për shkak të rritjes së eksporteve; eksporteve të energjisë elektrike dhe turizmit në Shqipëri dhe investimeve publike, prodhimit dhe investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit.

¹ EJL6-a përfshin këto shtete: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Raporti i referohet shpesh BE11-ës dhe BE15-ës për krahasim. BE11-a përfshin shtetet e reja anëtare, përfshirë dhe Qipron dhe Maltën. BE15-a përfshin shtete të tjera më të vjetra anëtare.

Situatat shokuese të motit kanë qenë shkaktarët kryesorë të performancës së keqe ekonomike në EJL6. Përmbytjet në maj të 2014-ës vlerëson t'i kenë kushtuar Bosnjes dhe Hercegovinës rreth 15 përqind të PBB-së si rezultat i humbjes së produkteve, ndërsa dëmtimet në Serbi vlerësohen në rreth 4.7 përqind të PBB-së. Impiantet e dëmtuara të prodhimit të energjisë i kanë shkaktuar dëme bizneseve në Serbi, ndërsa dëmtimi i të mbjellave cenoi produktin bujqësor në Bosnje dhe Hercegovinë. Thuajse asnjë segment i këtyre dy ekonomive nuk mbeti i padëmtuar. Ndikimi domethënës i motit të keq tregon se ekonomitë e vendeve të EJL6-ës nuk janë të përgatitura mirë për variacionin e shtuar të motit.

Rritja e eksporteve ka kompensuar performancën e dobët ekonomike të EJL6-ës në frontin e brendshëm, por nuk ka qenë e mjaftueshme për të ngushtuar mungesat e balancave të jashtme dhe për të ulur borxhin e jashtëm. Katër shtete të EJL6-ës (në përjashtim të Shqipërisë dhe të Malit të Zi) patën rritje eksportesh në gjysmën e dytë të 2014-ës. Dy shtete në rajon, Serbia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, kanë shënuar rritje eksporti me dy shifra në gjysmën e parë të vitit 2014, të shtyra nga vlera e lartë e produkteve industriale (makina dhe makineri elektrike) dhe/ose lëndë të parë të prodhuar nga fabrikat e financuara nga investimet e huaja direkte. Pavarësisht nga performanca e arsyeshme e eksportit, rritja e importeve (pjesërisht si rezultat i importeve për rindërtim pas përmbytjeve në rajon) çoi në përkeqësimin e deficiteve të llogarive korrente në rajon. Kjo ndodhi pavarësisht nga ulja e çmimit të naftës kohët e fundit, ndikimi i plotë i së cilës ka të ngjarë të mos jetë i dukshëm deri në fund të tremujorit të fundit të 2014-ës. Si pasojë e zgjerimit të mungesës së balancave të jashtme, borxhi i jashtëm i EJL6-ës pritet të jetë rritur me 3.5 pikë përqindje të PBB-së në vitin 2014, duke arritur mesataren e 68.9 përqind të PBB-së në fund të vitit.

Deficiti mesatar fiskal në EJL6 vlerësohet të jetë rritur nga 0.4 përqind e PBB-së në 4.2 përqind në vitin 2014 për shkak të rritjes më të shpejtë të shpenzimeve sesa të të ardhurave. Shpenzimet parashikohen të jenë rritur si përqindje e PBB-së në Shqipëri (pjesërisht për shkak të shlyerjes së pagesave të prapambetura të qeverisë), Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi (pjesërisht për shkak të shpenzimeve rindërtuese pas përmbytjeve), por të kenë rënë disi në tri shtetet e tjera të EJL-së. Të ardhurat e rritura tatimore gjatë vitit deri në shtator në të gjitha shtetet e EJL6-ës (përveç Kosovës) nuk mundën të kompensojnë rritjen e shpenzimeve publike. Rritja më e madhe e deficitit fiskal ndërmjet shteteve të EJL6-ës pritet në Bosnje dhe Hercegovinë (nga 1.9 në vitin 2013 në 4.5 përqind të PBB-së në fund të vitit 2014). Edhe Serbia mendohet të ketë përkeqësuar pozicionin e saj fiskal (nga 5.6 në vitin 2013 në 7.9 përqind të PBB-së deri në fund të 2014-ës), dhe ka mbetur vendi me deficitin më të madh dhe më të paqëndrueshëm fiskal në EJL6.

Deficiti publik vlerësohet të jetë rritur me 3 përqind të PBB-së në vitin 2014, duke i rritur nivelet mesatare të borxhit në EJL6 në 52.3 përqind të PBB-së. Kjo përfaqëson një rritje të vazhdueshme që prej fillimit të krizës globale: në periudhën ndërmjet vitit 2009 dhe 2014, raporti mesatar ndërmjet borxhit publik dhe PBB-së në shtetet e EJL6-ës vlerësohet të jetë rritur me thuajse 18 përqind e PBB-së. Nivelet e borxhit publik janë mbi 60 përqind e PBB-së në tre shtete të EJL6-ës (Shqipëri, Mal i Zi dhe Serbi). Megjithëse në nivele të ulëta, borxhi publik në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka vijuar të rritet dhe e ka tejkaluar nivelin e 40 përqind të PBB-së deri në fund të 2014-ës.

Kosova ka ende nivel të ulët të borxhit publik, por tendencat në rritje gjatë kohëve të fundit ngrenë shqetësime.

Parashikimi për 2015-ën

Si i tërë rajoni i EJL6-ës parashikohet të rritet me 1.3 përqind në vitin 2015, mbështetur nga kërkesa e jashtme gradualisht në rimëkëmbje, veçanërisht në Evropë, dhe nga stabilizimi i çmimeve të energjisë elektrike rreth niveleve aktuale. Sipas skenarit bazë, kërkesa e jashtme do të mbetet shtytësi kyç i rritjes në mbështetje të aktivitetit industrial të EJL6-ës dhe rritjes së eksporteve. Kushtet e favorshme të politikave monetare të Eurozonës kanë të ngjarë të vijojnë ta ndihmojnë EJL6-ën të rrisë eksportet. Për më tepër, çmimet relativisht të ulëta të naftës, të shoqëruara si me përpjekjet e familjarëve dhe të qeverisë për rindërtim pas dëmeve të shkaktuara nga ngjarjet klimaterike të kohëve të fundit mund të mbështesin kërkesën e brendshme dhe të kenë ndikim pozitiv mbi rritjen në rajon. Megjithatë, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, kërkesa e brendshme në EJL6-ës ka të ngjarë të mbetet e ndrydhur pasi besimi i konsumatorëve dhe i biznesit mbeten të dobëta për shkak të pasigurisë së zgjatur politike, papunësisë së lartë kronike, klimës së dobët të biznesit, dhe sistemeve bankare të ngarkuara shumë me hua të këqija. Performanca e tregut të punës në EJL6 ka të ngjarë të përkeqësohet (ose në rastin më të mirë të mbetet në vend) pasi rënia e ritmit të rritjes në vitin 2014 në Serbi dhe në Bosnje dhe Hercegovinë ka të ngjarë të reflektohet tek rezultatet e tregut të punës me ca vonesa. Nga ana tjetër, mund të priten përmirësime të vogla në nivelin e punësimit në një rajon (në EJL6) me rritje më të shpejtë. Përpjekjet për konsolidim fiskal mendohet të vazhdojnë në vitin 2015 në EJL6, me përjashtim të Malit të Zi, ku fillimi i projektit të ndërtimit të një autostrade do të rrisë ndjeshëm deficitin fiskal. Në aspektin e jashtëm, bilancet e llogarive korrente të EJL6-ës ka të ngjarë të stabilizohen rreth niveleve aktuale, pasi rritjet e pritshme në kërkesën e jashtme për eksportet e EJL6-ës kompensohen kryesisht nga rritja e importeve në mbështetje të kërkesës së brendshme.

Rritja pritet të jetë pozitive në të gjithë EJL6-ën, me përjashtim të Serbisë. Serbia ka të ngjarë të mbetet në stanjacion në kushtet e kërkesës së brendshme të dobët dhe konsolidimit të vështirë fiskal. Bosnja dhe Hercegovina ka të ngjarë të nisë të rimëkëmbet gradualisht. Shqipëria, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonsië dhe Mali i Zi priten të rriten me mbi 3 përqind në vitin 2015.

Parashikimet për rritje në EJL6 shoqërohen me rreziqet e disavantazheve. Rreziqet kryesore përfshijnë: (i) efektet e konsolidimit vijues dhe të planifikuar fiskal dhe programet e privatizimit mund të kenë ndikim negativ mbi mbështetjen e publikut për reformat; (ii) rreziku i deflacionit mund të vijoje të ushtrojë presion negativ mbi rritjen; (iii) performanca e dobët ekonomike në Eurozonë mund të kufizojë kërkesën e jashtme për eksporte në EJL6 dhe disponueshmërinë financuese për shtetet e EJL6-ës; (iv) për shkak të lidhjeve të ngushta ndërmjet BE-së dhe Rusisë, ekonomitë e EJL6-ës janë të ndjeshme ndaj efekteve të tensioneve gjeopolitike që mund të intensifikohen për shkak të krizës Rusi-Ukrainë; dhe (v) rajoni ka treguar vulnerabilitet të lartë përkundrejt kushteve të këqija të motit. Në aspektin pozitiv, çmimet e ulëta të naftës mund të ndihmojnë për nxitjen e rritjes dhe uljen e deficiteve të llogarive korrente.

Ndryshimet strukturore vijojnë të mbajnë peng rritjen potenciale në EJL6. Funksionimi i tregjeve të punës në të gjithë rajonin është anemik, me nivele të vazhdueshme të larta të papunësisë, nivele të ulëta të pjesëmarrjes së krahut të punës dhe krijimin e ngadaltë të vendeve të punës. Megjithëse është bërë ca përparim për lehtësimin e barrave të klimës së investimeve, ka ende vend për përmirësim. Sektori publik është i madh dhe jo eficient në shumë prej shteteve të rajonit. Në të gjitha shtetet, investimet për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe/ose përmirësimin e stokut kapital do të ndihmonin për zëvendësimin e infrastrukturës aktuale të vjetëruar dhe për nxitjen e potencialit ekonomik, me kusht që këto investime të kenë kthime ekonomike pozitive dhe të mos kërcënojnë qëndrueshmërinë e borxhit publik. Përmirësimi i lidhjes së rajonit të EJL6-ës nëpërmjet lidhjeve fizike dhe institucionale ndërmjet vendeve të rajonit, me BE-në, dhe me pjesën tjetër të botës, do t'i ndihmojë firmat konkurruese të EJL6-ës të mbërrinë në tregje të reja dhe do të bëjë të mundur thithjen e investitorëve të huaj në rajon. Përparimi në procesin e pranimit në BE përfaqëson një mundësi për EJL6-ën për të ndjekur axhendën e BE-së, e cila ka po ashtu ndikim pozitiv mbi rritjen potenciale. Rritja ekonomike në kuadrin e afërt dhe afatmesëm në EJL6 mund të mbështetet nëpërmjet politikave ekonomike të shëndetshme dhe parësore, të cilat do t'i trajtojnë këto pengesa strukturore.

I. ZHVILLIMI REAL EKONOMIK

Sektori real

Rimëkëmbja ekonomike e EJL6-ës u lëkund teksa ngjarje shokuese klimaterike e goditën rajonin në vitin 2014. Përmbytjet e majit të vitit 2014 i shkatërruan ekonomitë e Bosnje-Hercegovinës dhe Serbisë, duke çuar në dëme dhe humbje që llogariten përkatësisht në rreth 15 përqind të PBB-së. Këto humbje janë të krahasueshme me përmbytjet shkatërruese në Tajlandë në vitin 2011, të cilat u vlerësuan në rreth 14 përqind e PBB-së² nga Vlerësimi i Dëmeve dhe Humbjeve. Ekonomia serbe vlerësohet të jetë tkurrur me 2.0 përqind, ndërsa ekonomia e Bosnjes dhe Hercegovinës pritet të qëndrojë në vend me 0.4 përqind në vitin 2014, pavarësisht disa përmirësimeve gjatë gjysmës së dytë të vitit (Tabela 1). Moti i keq ka dobësuar po ashtu rritjen në Malin e Zi, duke ulur eksportet për turizmin dhe energjinë elektrike. Të përkeqësuar nga rënia në prodhim, këto zhvillime nënkuptojnë që EJL6-a pritet që të lërë pas me veshitësi stanjacionin e vitit 2014, duke u rritur vetëm me 0.2 përqind, goxha më poshtë parashikimit prej 1.9 përqind të majit të vitit të shkuar.³

Megjithatë, performanca mesatare rajonale ekonomike i maskon dasitë ndërmjet shteteve të EJL6-ës. Shqipëria dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk pritet të pësojnë ndonjë ngadalësim në performancën e rritjes, ndryshe nga pjesa tjetër e EJG6-ës. Të dyja këto ekonomi nuk u prekën nga ngjarjet tronditëse të motit. Për më tepër, rritja e eksporteve të turizmit në Shqipëri dhe eksportet e lidhura me investimet e huaja direkte në Maqedoni, të shoqëruara nga forcimi i kërkesës së brendshme, mendohet të kenë nxitur rritjen në vitin 2014. Në anën tjetër të medaljes, nivelet e rritjes në Kosovë dhe në Mal të Zi vlerësohen të jenë ulur në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013, Serbia vlerësohet të ketë rënë në recesion, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina ka qëndruar në stanjacion në vitin 2014.

² Shih Banka Botërore 2011. *Përmbytjet në Tajlandë 2011: Vlerësim i Shpejtë për Rimëkëmbjen Aktive dhe Plani i Rindërtimit*


³ Shih Banka Botërore 2014. *Raporti i Rregullt Ekonomik për Evropën Juglindore Nr. 6: Rimëkëmbje e Brishtë*. Maj 2014. Washington DC.

Tabela 1: Parashikimet e rritjes reale të PBB-së në vitin 2014

	maj 2014	Janar 2015
ALB	2.1	2.1
BIH	2.0	0.4
KOS	3.5	2.5
MKD	3.0	3.3
MNE	3.2	1.5
SRB	1.0	-2.0
<i>EJL6</i>	<i>1.9</i>	<i>0.2</i>

Burimi: Parashikimet e Bankës Botërore

Figura 1: Rritja reale e PBB-së, 2012-14



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe parashikimet e Bankës Botërore

Përveç motit, për lëkundjen e perspektivës rajonale të rritjes për EJL6-ën në vitin 2014 kanë luajtur rol tre faktorë të tjerë si në frontin e brendshëm dhe në atë të jashtëm:

- (i) **Investimet publike**, të cilat përbëjnë shtysë të madhe për rritjen në të gjithë rajonin, janë vonuar ose janë ndërprerë në shumë shtete. Për shembull, investimet e planifikuara nuk janë ekzekutuar as në Kosovë dhe as në Shqipëri. Në Shqipëri investimet publike janë shkurtuar edhe si pjesë e një programi më të gjerë konsolidimi fiskal. Pasiguria e shkaktuar nga zgjedhjet e përgjithshme në Bosnje dhe në Hercegovinë ka shkaktuar pengesa në investime. Në Malin e Zi, jo vetëm është shtyrë dita e fillimit të punimeve për ndërtimin e një autostrade për në vitin 2015, por edhe **investimet private** kanë qenë më të ulëta sesa pritshmëritë.
- (ii) **Ngadalësimi i disa ekonomive të avancuara dhe ekonomive të reja** ka ulur rritjen globale me pasojë për performancën ekonomike të EJL6-ën. Pa dyshim që këtu përfshihet dhe paaftësia e vendeve të Eurozonës për t'u rimëkëmbur plotësisht, ngadalësimin e rritjes në Kinë dhe recesionin e Rusisë. Megjithatë kërkesa e jashtme për eksportet e EJL6-ës ka pasur ndikim pozitiv mbi rritjen, kontributi i saj ka qenë i kufizuar (Kutia I).
- (iii) **Rënia e çmimit të naftës** nga fundi i vitit 2014 pritet të ketë efekt të kundërt mbi performancën ekonomike të vendeve të EJL6-ës. Si shtete importuese për naftën, EJL6-a ka përfituar nga rënia e çmimeve të naftës në vitin 2014, në përjashtim të Shqipërisë për shkak të eksporteve të larta të naftës.

Kutia I: Zhvillimet globale ekonomike

Ekonomia botërore po lufton ende të fitojë terren ndërsa shumë shtete me të ardhura të larta vijojnë të përballen me pasojat e krizës globale financiare. Rritja globale u përshpejtua shumë pak duke arritur në nivelin prej 2.6 përqind në vitin 2014 nga 2.5 përqind në vitin 2013. Rritja në vendet me të ardhura të larta është bërë edhe më e larmishme, me Shtetet e Bashkuara që kanë fituar terren dhe me Eurozonën dhe Japoninë që kanë mbetur ende mbrapa. Në **Shtetet e Bashkuara**, në përjashtim të kontraktimit të përkohshëm në fillim të vitit 2014, rritja ka qenë


mbi potencialin prej mesit të vitit 2013, ndërsa në tremujorin e tretë të vitit 2014 arriti ritmin e saj më të shpejtë që prej vitit 2003. Rimëkëmbja është mbështetur nga politika monetare të favorshme, të cilat kanë mbështetur vlerësimet e tregut kapital dhe kanë lehtësuar konsolidimin fiskal. Përmirësimi i tregjeve të punës është karakterizuar nga krijimi i vendeve të qëndrueshme të punës dhe rritje graduale e pagave. Kushtet e tregut të banesave janë përmirësuar, ndërsa ulja e çmimit të naftës po rrit realisht të ardhurat e familjeve. Me zvogëlimin e kapacitetit të papërdorur të ekonomisë, rritja e parë e fondeve federale pritet rreth mesit të vitit 2015, por shtrëngimi ka të ngjarë të jetë gradual për shkak të pritshmërive të pasigurta inflacioniste. Në **Eurozonë**, aktiviteti ka qenë më i dobët sesa pritej, veçanërisht në Francë, Gjermani dhe Itali. Shqetësimet për mundësitë afatgjata dhe pasojat e krizës (veçanërisht bilancet e dëmtuara dhe niveli i lartë i papunësisë) ushtrojnë trysni mbi rimëkëmbjen e brishtë dhe zvogëlojnë përfitimet e pritshme të rritjes nga çmimet e ulëta të qëndrueshme të naftës. Në **Japoni**, në nivelin 0.2 përqind, rritja në vitin 2014 ishte larg pritshmërive, pasi ekonomia nuk ia arriti të rimëkëmbej nga rritja e tatimit mbi shitjet në prill të 2004-ës dhe, deri në mes të vitit 2014, eksportet mbetën të ndrydhura pavarësisht jenit të dobët, duke reflektuar kërkesën e ulët globale, rishpërndarjen e njësisë të prodhimit gjetkë në botë, dhe çmimin e rritur të importeve të energjisë që prej mbylljes së reaktorëve bërthamorë. Ndërsa papunësia është e ulët, pjesëmarrja në tregun e punës mbetet më e ulët sesa nivelet para krizës, ndërsa rritja reale e pagave është e ngurtësuar. Në qershor të vitit 2014, qeveria njoftoi një seri reformash produkti dhe tregu pune, gjerësisht në përputhje me rekomandimet e OECD-së dhe pritet të përshpejtojë zbatimin e tyre pas zgjedhjeve të dhjetorit të 2014-ës. Rritja në **vendet në zhvillim** ra në 4.4 përqind në vitin 2014. Ngadalësimi në shumë ekonomi të mëdha me nivel mesatar të ardhurash reflekton kryesisht faktorë ciklikë, shtrëngim të politikave të brendshme dhe tensione politike. Megjithatë, faktorë më të thellë strukturorë, përfshirë dhe uljen e tendencës në produktivitet, cenojnë perspektivat për rritje në kuadrin afatmesëm. Që prej marrjes së vetes pas krizës, rritja e produktit në botën në zhvillim është vendosur në një ritëm nën ritmin e dekadës së parë të viteve 2000. Ulja e ndjeshme në çmimin e naftës dhe të mallrave të tjera dhe zbutja e rritjes, pjesërisht për shkak të politikave më të shtrënguara monetare, po ndihmon në uljen e presioneve inflacioniste. Në shtetet me të ardhura të ulëta, rritja ka vijuar e shëndetshme në kurriz të investimeve publike në rritje, prurjeve të shumta kapitale, të korrave të mira, dhe përmirësimit të sigurisë në disa vende konflikti (si, për shembull në Mianmar, Republikën e Afrikës Qendrore, Mali). Moderimi i çmimeve globale në ushqime dhe energji elektrike në vitin 2014 ka kontribuar për uljen e inflacionit, gjë e cila ka qenë veçanërisht e rëndësishme në Afrikën Subsahariane.

Kushtet beninjë financiare në pjesën më të madhe të vitit 2014 i kanë lejuar shteteve në zhvillim të vijnë me preken e tregjeve ndërkombëtare të obligacioneve me ritëm rekord, megjithëse tregjet financiare u trazuan më vonë gjatë vitit. Ndërsa bankat kryesore qëndrore kanë shprehur angazhimin e tyre për ruajtjen e politikave përjashtimisht avatazhuese për mbështetjen e aktiviteteve, tregjet kanë pasur tendencë t'i interpretojnë lajmet negative si arsye për favorizim të mëtejshëm të politikave monetare. Si rezultat, korrigjimet në aktive dhe tregjet e obligacioneve me jild të lartë janë rikuperuar shpejt në përgjigje të disa shpërthimeve të konflikteve gjeopolitike dhe epidemive të sëmundjeve. Pritshmëritë për politikën monetare gjithnjë e më shumë të larmishme në bankat kryesore qëndrore, kanë shkaktuar po ashtu një vlerësim të gjerë të dollarit amerikan dhe një presion të ri mbi monedhat e disa vendeve në zhvillim. Monedhat e Evropës Qendrore dhe Lindore, të lidhura ngushtë me euron dhe të prekura nga trazitë gjeopolitike në rajon, janë zhvlerësuar ndjeshëm përkundrejt dollarit amerikan, megjithëse jo përkundrejt euros. Disa eksportues mallrash, ne veçanti në Rusi dhe në Amerikën Latine, kanë parë po ashtu presione të reja të këmbimit valutor, duke reflektuar ndikimin e kombinuar të forcimit të përgjithshëm të dollarit, zbutjen e çmimit të mallrave dhe pasiguritë e brendshme.

Ekonomia rajonale e EJL6-ës filloi të ngadalësohej në gjysmën e parë të 2014-ës. Rritja në të gjithë rajonin ishte ulur në nivelin 1.5 përqind në tremujorin e parë të 2014-ës (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) nga 2.4 përqind në tremujorin e parë të 2013-ës (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) (Figura 2). Në tremujorin e dytë të 2014-ës, ekonomia e rajonit u kontraktua me 0.2 përqind (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë). Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë


është i vetmi vend ku rritja pësoi përparim gjatë gjysmës së parë të 2014-ës për shkak të rritjes së investimeve publike dhe eksporteve të financuara nga investimet e huaja të drejtpërdrejta.⁴ Të dhënat e disponueshme tregojnë se rimëkëmbja rajonale ka të ngjarë të ulet në tremujorin e tretë, pasi ekonomia më e madhe e rajonit, Serbia, është kontaktuar në nivelin 3.6 përqind për shkak të uljes së aktivitetit industrial dhe të ndërtimit pavarësisht se pjesa tjetër e shteteve të rajonit shfaqin shenja të rritjes së aktivitetit ekonomik.

Figura 2: Rritja tremujore reale e PBB-së, 2013-14



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave.

Figura 3: Prodhimi tremujor industrial, 2013-14



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave.

Ngjarjet atmosferike tronditëse ulën kapacitetin prodhues të energjisë elektrike dhe në bujqësi në rajonin e EJL6-ës. Bujqësia ishte një ndër sektorët kryesorë të goditur fort nga përmbytjet e majit të vitit 2014. Në Bosnje dhe Hercegovinë, vlera e shtuar bujqësore u kontraktua me 10.9 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2014 (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) dhe 10.2 përqind në tremujorin e tretë të 2014-ës (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë), ndërsa vlera e shtuar e energjisë elektrike ra me 12.6 përqind (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) dhe 4.0 përqind (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) gjatë të njëjtës periudhë.⁵ Në Serbi, produkti i sektorit energjistik në periudhën nga maji deri në tetor të 2014-ës, pas përmbytjeve, ishte 33 përqind më i ulët sesa në të njëjtën periudhë të vitit 2013. Sektori energjistik mbulon 3.4 përqind të PBB-së dhe rreth 15 përqind të produktit të përgjithshëm industrial në Serbi. Për pasojë, kjo ulje ka kontribuar në rreth një të tretën e kontraktimit të përgjithshëm të projektuar prej 2 përqind në PBB-në e Serbisë në vitin 2014. Prodhimi dhe eksportet bujqësore pritet të ndjejnë efektet e përmbytjeve gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Rritja e prodhimit industrial ka qenë negative në pjesën më të madhe të vendeve. Në përgjithësi, rritja e prodhimit industrial e ka ulur ritmin në tremujorin e parë të vitit 2014 në të gjitha vendet e rajonit, në përjashtim të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në dy tremujorët pasues, situata u përkeqësua më tej në Mal të Zi dhe në Serbi, ku prodhimi industrial u kontraktua deri në 26 përqind. Shqipëria i pa

⁴ FYR Macedonia 2013 GDP figures have been revised down to 2.7 percent. The quarterly figures are yet to be revised.

⁵ Agricultural value added includes also forestry and fishing whereas electricity value added includes also gas, steam, and air conditioning supply.

sektorët e prodhimit, ndërtimit dhe transportit të përjetonin kontraktime të mëdha në tremujorin e parë të 2014-ës, pjesërisht për shkak të uljes së investimeve publike, por prodhimi industrial shqiptar u rimëkëmb disi në tremujorin e tretë (duke u rritur me afërsisht 2.5 përqind), në Bosnje dhe Hercegovinë kontraktimi i filluar në tremujorin e dytë u çtendos në tremujorin e tretë. Prodhimi industrial në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë vijoi të shtrihej më tej pjesërisht për shkak të kërkesës së jashtme të qëndrueshme (Figura 3).

Performanca rajonale e eksportit në EJL6 ka ushtruar një ndikim të lehtë pozitiv mbi rritjen në vitin 2014. Tre vende të rajonit, Serbia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova, shënuan rritje eksporti me dy shifra në gjysmën e parë të vitit 2014. Në Serbi dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, rritja e eksportit është shtyrë nga produkte industriale me vlerë të lartë (makina dhe makineri elektrike) të kërkuara në tregun evropian dhe të prodhuara nga fabrikat e financuara nga investimet e huaja të direkte. Eksportet e Kosovës janë rritur për shkak të zgjerimit të bazë së prodhimit, por mbetën ende të ulëta si përqindje e PBB-së (më pak se 20 përqind e PBB-së, ndërmjet eksporteve më të ulëta në botë) dhe përqendrohen tek materialet për lëndë të parë. Eksportet prej këtyre tre shteteve përbënin thuhetse 80 përqind të totalit të eksporteve të EJL6-ës në vitin 2014, duke e çuar kontributin pozitiv të eksporteve në rritjen e përgjithshme të EJL6-ës. Eksportet nga Mali i Zi kanë rënë me 11.8 përqind gjatë vitit, deri në nëntor krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013, kryesisht për shkak të rënies së eksporteve në energji elektrike të ndikuara nga kushtet ekstreme të motit, si dhe riparimi kapital vjetor i një termocentrali që zgjati më shumë sesa ishte parashikuar.

Eksportet pritet të kenë kontribuar pozitivisht mbi rritjen ekonomike në gjysmën e dytë të 2014-ës. Efektet kishin gjasa të ishin relativisht të larta në Shqipëri ku niveli i rritjes në gjysmën e dytë pritej të kompensonte performancën e dobët të dy tremujorëve të parë, duke çuar në përshpejtim të butë të rritjes nga 1.4 përqind në vitin 2013 deri në 2.1 përqind në vitin 2014. Edhe Mali i Zi mendohet të përfitojë nga të ardhurat në rritje të turizmit, por ato ka të ngjarë të mos mund të kompensojnë performancën e dobët të rritjes në gjysmën e parë të vitit.

Megjithatë, si përqindje e PBB-së në EJL6, eksportet mbeten të ulëta dhe nën potencial. Eksportet vlerësoheshin në rreth 38 përqind të PBB-së në 2013-ën në vendet e EJL6-ës. Kjo krahasohet me mbi 60 përqind në shtetet e BE11-ës. Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë shënuar rezultate të këqija, me eksporte përkatësisht me rreth 20 dhe 30 përqind e PBB-së. Analiza e kohëve të fundit tregon se eksportet e rajonit janë goxha nën potencial, veçanërisht krahasuar me bllokun më të madh ekonomik të botës që është fqinj me rajonin, pra me BE-në. Eksportet e Shqipërisë me BE-në vlerësohen me 40 përqind nën potencial, ndërsa eksportet nga shtetet e tjera të EJL6-ës janë rreth 30 përqind nën potencial.⁶

Kutia II. Ndikimi ekonomik i ngjarjeve tronditëse klimaterike në EJL6

Rajoni i EJL6-ës është përballur me disa ngjarje moti ekstrem gjatë tre viteve të fundit, të cilat kanë pasur ndikimet përkatëse mbi rritjen ekonomike. Në shkurt të vitit 2012, EJL6-a u godit fort nga një dimër i acartë, i cili çoi në gjendje emergjence në disa vende. Shtetet në EJL6 u hasën me probleme të ndryshme: mungesa në furnizimin

⁶ Shih Bankën Botërore. 2014. *Raporti i Rregullt Ekonomik për Evropën Juglindore Nr. 6: Rimëkëmbje e Brishtë*. Maj 2014. Washington DC për më shumë detaje.

me ujë, gaz dhe medikamente, ndërprerje të energjisë elektrike dhe të telekomunikacioneve, ortekë, dhe mungesa të sistemeve të transportit. Produkti ekonomik u ul pasi ndërtimi u ngadalësua më shumë se zakonisht gjatë dimrit, punëdhënësit nuk kishin mundësi të shkonin në punë dhe konsumatorët nuk blinin. **Kjo u shoqërua nga një thatësi në verën e vitit 2012.** Hidrocentralet prodhojnë rreth 15 përqind të energjisë elektrike në EJL6 dhe disa shtete mbështeten kryesisht tek ky burim energjie. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi mbështeten veçanërisht tek hidrocentralet, të cilat prodhojnë afro 100 përqind të të gjithë energjisë elektrike në Shqipëri, rreth një të tretën në Bosnje dhe Hercegovinë dhe gjysmën në Malin e Zi. Furnizimi me energji elektrike u reduktua nga thatësira në një rajon thuajse të etur për energji, duke dëmtuar bizneset dhe familjet. Në të njëjtën kohë, thatësira pati ndikim dhe mbi produktin bujqësor në EJL6. **Ndërmjet tyre, dimri i ashpër dhe thatësira e verës ndihmuan në shtyrjen e EJL6-ës në një recesion të dyfishtë në vitin 2012.** Produkti në rajon ra me 0.6 përqind në vitin 2012 dhe vetëm Shqipëria dhe Kosova përjetuan rritje pozitive (edicioni i raportit të EJL6-ës në qershor të vitit 2013).

Në maj të vitit 2014, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia u goditën fort nga përmbytjet. Shirat ishin më të dendurat që kur kanë filluar të mbahen të dhëna, 120 vjet më parë. Një përqindje e lartë e popullsisë dhe masës tokësore janë prekur negativisht nga përmbytjet, veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë. Në rastin e fundit, “në fund të majit 2014, 25 persona kishin humbur jetën, rreth 90,000 të tjerë ishin evakuuar dhe rreth 1 milionë ose një e katërta e popullsisë së përgjithshme ishte prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përmbytjet. Zona e prekur mbulonte më shumë se një të tretën e territorit të vendit, ndërsa përmbytjet masive kanë shkaktuar mbi 3,000 rrëshqitje toke.”⁷

Një Vlerësim i Rimëkëmbjes dhe Nevojave vlerëson se ndikimi kumulativ mund të ishte i mjaftueshëm për ta kthyer sërish në recesion Bosnje dhe Hercegovinën dhe për të ulur ndjeshëm rezultatin në Serbi, për të rritur varfërinë dhe për të ushtruar presion mbi financat publike. Përmbytjet vlerësohen se kanë shkaktuar ekuivalentin e afërsisht 15 përqind të PBB-së në dëme (9.3 përqind të PBB-së) dhe humbje (5.6 përqind) në vitin 2014 në Bosnje dhe Hercegovinë.⁸ Kostot e rindërtimit ushtrojnë presion mbi financat publike mbi të dyja shtetet dhe rrisin CAD-në për shkak se materialet rindërtuese importohen. Eksportet bujqësore në Bosnje dhe Hercegovinë kanë pësuar dëme për shkak të shkatërrimit të madh të të mbjellave. Në Serbi, përmbytjet vlerësohet të kenë shkaktuar rreth 864 milionë euro dëme dhe 648 milionë euro humbje. Kjo përkthehet përkatësisht në 2.7 përqind të PBB-së në dëme dhe 2 përqind të PBB-së në humbje në vitin 2014. Sektorët ekonomikë të goditur më shumë ishin sektori i energjisë, minierave, dhe bujqësia, por dëme të mëdha u shkaktuan po ashtu dhe nga infrastruktura e transportit (rrugët, urat dhe hekurudhat).

Bosnja dhe Hercegovina u godit nga një valë e dytë përmbytjesh në gusht të vitit 2014, dhe kushtet e këqija të motit patën ndikim negativ mbi Malin e Zi. Megjithëse shkatërrimi ishte larg niveleve të shkatërrimit të përmbytjeve të majit, shirat në shtator në Bosnje dhe Hercegovinë ishin të mjaftueshme për të shkaktuar alarm dhe për të shërbyer si paralajmërim i mëtejshëm për vulnerabilitetin e rajonit ndaj ngjarjeve tronditëse klimaterike. Nivelet e ulëta të reshjeve të kombinuara me kushtet e këqija të verës në Malin e Zi çuan në uljen e prodhimit të energjisë elektrike dhe të eksporteve, përfshirë turizmin, duke çuar kështu në uljen e ritmit të rritjes ekonomike.


Ndikimi i këtyre situatave tronditëse klimaterike tregon për rëndësinë e krijimit të një fleksibiliteti më të madh ndaj kushteve ekstreme të motit dhe ndryshimeve klimaterike. Duke pasur parasysh profilin e rajonit dhe ekspozimin pasues të aktivitetit ekonomik ndaj fatkeqësive natyrore, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, ekspozimi i PBB-së ndaj përmbytjeve është mjaftueshëm i lartë për të induktuar stres fiskal dhe për të vonuar rimëkëmbjen dhe ekonominë. Ndikimi i ngjarjeve më pak të shpeshta mund të jetë edhe më shumë i madh. Modelet nga Grupi i Bankës Botërore tregojnë se një përmbytje një herë në 100 vjet mund të prekë 18 përqind ose më shumë të PBB-së së Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, 14 përqind ose më shumë të PBB-së së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe 12 përqind ose më shumë të PBB-së së Serbisë për disa vite.

⁷ Bosnja dhe Hercegovina – Projekti për Rimëkëmbjen nga Emergjencia nga Përmbytjet. Banka Botërore. 2014.

⁸ <http://europa.ba/Download.aspx?id=1521&lang=EN> dhe http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/floods/ma-executive-summary.pdf

Dëmi ose humbjet pasuese të dëmit publik mund të shkojnë përkatësisht në 9, 4 dhe 5 përqind të PBB-së së vendit. Përqindje të mëdha të popullsisë do të ekspozoheshin ndaj përmbytjeve një herë në 100 vjet (Figura BII.1).

Figura BII.1: Ekspozimi i aktivitetit ekonomik dhe i popullsisë ndaj përmbytjeve një herë në 100 vjet në EJL6



Burimi: Parashikimet e Bankës Botërore.

Përmbytjet e fundit në Bosnje dhe Hercegovinë tregojnë se mund të ketë vlerësime konservative. Ndryshimet klimaterike mund ta bëjnë edhe më vulnerabël rajonin, kështu që përgatitja për të tashmen dhe për të ardhmen duhet të promovojnë hartimin e Menaxhimit të Rrezikut për Fatkeqësitë (DRM) dhe miratimin e strategjive afatgjata për zhvillim.

Tregtia me jashtë dhe sektori i jashtëm

Niveli aktual i deficitit pritet të jetë zgjeruar lehtësisht në vitin 2014, pasi rritja e eksporteve nuk ia arriti të kompensonte rritjen e importeve. Niveli aktual i deficitit në rajon (mesatarja e ponderuar) u rrit nga 8.0 përqind të PBB-së në gjysmën e parë të 2013-ës në 8.3 përqind të PBB-së në të njëjtën periudhë të vitit 2014, me prishjen e balancës së jashtme në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Malin e Zi (Figura 4). Në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë, zgjerimi i deficitit u shty kryesisht nga importet, të cilat u rritën me mesatarisht 5.7 përqind gjatë gjysmës së parë të 2014-ës (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë). Në këto vende eksportet u rritën po ashtu gjatë të njëjtës periudhë, megjithëse me vetëm 3.3 përqind, dhe, të shoqëruara me bazën e ulët, nuk arritën të kompensonin rritjen e importeve (Figurat 6, 7). Në Shqipëri dhe Malin e Zi, rënia domethënëse në eksporte u shoqërua me një ulje të lehtë të importeve. Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Serbi, balancet e niveleve aktuale janë përmirësuar ndjeshëm ndërsa rritja e eksporteve e tejkaloi rritjen e importeve dhe deficitet tregtare u ngushtuan. Eksportet u rritën me 19.7 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014 në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me 11.3 përqind në Serbi.

Figura 4: Balanci i nivelit aktual, 6M1 2013-14




Figura 5: Balanci tregtar, 6M1 2013-14




Figura 6: Rritja e eksportit, 6M1 2013-14





Figura 7: Rritja e importit, 6M1 2013-14



Shënim: Të dhënat për BE11-ën dhe BE15-ën jepen për tremujorin e parë.

Burimi: Përllogaritjet e Bankës Botërore mbështetur në bankat qendrore, FMN WEO, dhe zyrat e statistikave.

Faktorët pas rritjes së eksporteve janë të ndryshëm. Në Shqipëri dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, rritja e importeve ka reflektuar forcimin e rimëkëmbjes dhe të importeve të lidhura me investimet e huaja direkte. Në Bosnje Hercegovinë dhe Serbi, importet janë rritur në përgjigje të përmbytjeve. Kosova përjetoi rritjen e eksporteve për shkak të rritjes së konsumit. Nga ana tjetër importet vijuan të uleshin në Malin e Zi, megjithëse në nivel më të ulët sesa një vit më parë.

Eksportet e EJL6-ës vijuan të rriteshin me ritëm të moderuar. Eksportet e EJL6-ës u rritën me 9.5 përqind në gjysmën e parë të vitit (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë), duke arritur një nivel pak më të lartë sesa 9.1 përqind regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit 2013 (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) (Figura 6). Kjo rritje u drejtua nga Shqipëria, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe në një masë më të vogël nga Bosnja dhe Hercegovina. Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbi, eksportet e prodhimit të financuara nga investimet e huaja direkte vijuan të rriteshin, megjithëse në një ritëm më të ulët në Serbi. Lëndët djegëse minerale dhe eksportet e tekstileve ishin shtyesa kryesore e rritjes së eksporteve në Shqipëri. Eksportet e mineraleve, veçanërisht eksportet e plumbit dhe xehrorëve të zinkut dhe ferro-nikelit nga Kosova janë rritur që prej gushtit, kryesisht drejt Kinës, pavarësisht ngadalësimit në Kinë.


BE-ja u bë një destinacion edhe më i rëndësishëm për eksportet e EJL6-ës në vitin 2014. Përqindja e eksporteve të mallrave në BE në totalin e eksporteve në EJL6 është rritur nga 62.4 përqind në vitin 2013 në 63.5 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014. Nga ana tjetër, përqindja e tregtisë ndër-rajonale në totalin e eksporteve të EJL6-ës ka rënë nga 24.7 përqind në vitin 2013 në 23 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014. Përjashtim nga kjo tendencë përbëjnë eksportet e Kosovës në Serbi, të cilat thuajse u dyfishuan në vitin 2014 (megjithëse nga një bazë e ulët) për shkak të përmirësimit të marrëdhënieve të tregtisë ndërmjet të dyja vendeve.

Performanca zhgënjyese e rritjes në Eurozonë vazhdon të kufizojë prurjet e remitancave.

Kontributi i remitancave për financimin e deficitit tregtar është i dukshëm në të gjithë EJL6-ën. Remitancat janë veçanërisht të rëndësishme për ekonomitë e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, dhe Kosovës, me burimin kryesor të remitancave nga ekonomitë e Greqisë, Italisë, Zvicrës, Austrisë dhe Gjermanisë. Gjatë gjysmës së parë të 2014-ës, remitancat u llogaritën në rreth 7.8 përqind e PBB-së (Figura 8), duke ndryshuar vetëm pak gjatë dy viteve të fundit dhe duke mbetur nën nivelet përpara krizës.

Prurjet neto të investimeve të huaja direkte kanë rënë vetëm pak. Prurjet e investimeve të huaja direkte në EJL6 llogariten në 4.4 përqind e

Figura 8: Remitancat, 6M1 2013-14




Shënim: Të dhënat për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë përfshijnë vetëm remitancat e punonjësve që vijnë nga kanale zyrtare bankare dhe të raportuara si të tilla, por jo të gjitha transfertat private që kanë efekt të konsiderueshëm mbi financimin e deficitit tregtar. Për Bosnje dhe Hercegovinë përdoret përkufizimi i ngushtë.

Burimi: Bankat qendrore dhe FMN-ja.


PBB-së në gjysmën e parë të vitit 2014, pak më poshtë nivelit prej 4.5 përqind të PBB-së në vitin 2013. Megjithatë mesatarja rajonale mbeti thuajse e paprekur krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013, eksperiencat në shtetet e rajonit ishin heterogjene (Figura 9). Prurjet neto të investimeve të huaja direkte në Serbi dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë rritur për shkak të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese të impianteve ekzistuese të financuara nga investimet e huaja direkte dhe të investimeve të reja në rastin e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Ndërkohë, pjesa tjetër e shteteve prurjet e investimeve të huaja direkte u ulën. Ulja më e theksuar në rajon u vu re në Kosovë, për shkak të rritjes së pasigurive rreth krizës politike paszgjedhore dhe dështimit të privatizimit të Postës dhe Telekomunikacioneve të Kosovës (PTK) në vitin 2013.

Figura 9: Investimet e Huaja Direkte neto, 6M1 2013-14



Burimi: Përlllogaritjet e Bankës Botërore mbështetur tek bankat qendrore.

Figura 10: Niveli aktual i financimit, 6M1 2014




Burimi: Banka Botërore mbështetur në bankat qendrore.

Deficitet e mëdha të llogarive korrente dhe prurjet e kufizuara të kapitalit kanë shkaktuar pakësimin e rezervave. Me shifrat aktuale të llogarive korrente të cilat ose janë dyshifrore ose janë shumë pranë të arriturit në nivele dyshifrore në të gjithë rajonin, financimi i deficitit përbën një çështje të rëndësishme për rajonin. Burimi i vetëm më domethënës i financimit të llogarive korrente gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 ishin investimet e huaja direkte (Figura 10). Ato kanë financuar mbi gjysmën e deficitit të llogarive korrente për EJL6-ën në tërësi, dhe mbi dy të tretat e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë. Megjithatë, prurjet e investimeve të huaja direkte mbetën shumë më poshtë prurjeve të shteteve fqinje të BE-së. Për shembull, prurjet e investimeve të huaja direkte në BE11 ishin dy herë më të larta se ato në EJL6 në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2013. Prurjet neto të mëdha nga “investimet e tjera” kanë ardhur kryesisht si rezultat i plotësimit të detyrimeve ndërkombëtare për pagim interesash, duke dëshmuar çështjet potenciale të qëndrueshmërisë së llogarive korrente (Kutia III e EJL6-ës).

Kushtet e dobëta ekonomike në Eurozonë, të shoqëruara me një klimë përgjithësisht të keqe investimesh në rajon, ka të ngjarë të kufizojnë rritjen e prurjeve për investime të huaja direkte. Ka shumë faktorë që përcaktojnë prurjet e investimeve të huaja direkte, ndërsa ekonomia e dobët në

Eurozonë padyshim i ul investimet e huaja direkte në rajon. Megjithatë, klima e investimeve në shtetet përfituese përbën po ashtu faktor kritik. Prurjet e investimeve të huaja direkte janë të ulëta pavarësisht nga fakti që shtetet e EJL6-ës kanë akses të mirë në tregjet perëndimore të BE-së falë afërsisë së tyre gjeografike dhe marrëveshjeve të tregtisë (Figura 11). Rajoni duhet ende të rrisë përfitimet nga afërsia me tregjet kapitale të BE-së. Megjithëse shtetet e EJL6-ës kanë bërë progres në reformimin e mjediseve të tyre rregullatore, raporti i fundit i *Të Bërit Biznes*⁹ sugjeron se ka ende fusha që kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. “Trajtimi i lejeve të ndërtimit,” “zbatimi i kontratave,” dhe “zgjidhja e aftësisë paguese” ngrihen veçanërisht si fusha që janë më të dobëta se të tjerat. Performanca e varfër në këto fusha duket se është reflektim i burokracisë së pavolitshme, korrupsionit dhe kuadreve të dobëta legislative në të gjithë rajonin.

Figura 11: Të bërit Biznes: Distanca për tek kufiri (100 = më e mira), 2015



Burimi: Treguesit e *Të Bërit Biznes* të Bankës Botërore (2015).


Ulja e borxhit të jashtëm në vitin 2013 pati jetëgjatësi të shkurtër. Borxhi i jashtëm i EJL6-ës arriti pra nivelin 68.5 përqind gjatë gjysmës së parë të 2014-ës pas rënies me thuajse 3 përqind të PBB-së në vitin 2013 (Figurat 12 dhe 13). Shkaku i rritjes së borxhit publik¹⁰ në rajon ishte rritja e borxhit publik në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi përkatësisht 3.9 dhe 4.4 pikë përqindje. Si Kosova dhe Shqipëria¹¹ kanë shënuar një ulje të lehtë të borxhit të jashtëm, por që nuk ka pasur shumë ndikim mbi mesataren e rajonit të EJL6-ës. Borxhi i jashtëm i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë u rrit më vonë gjatë vitit me 7 përqind të PBB-së për shkak të sigurimit të Eurobondit të planifikuar të përdoret pjesërisht për pagimin e detyrimit të borxhit në vitin 2015. Modelet sugjerojnë se niveli i qëndrueshëm i CAD-së (“gjendja e qëndrueshme”) ka pak të ngjarë të jetë e qëndrueshme në shumë prej shteteve të EJL6-ës për shkak të rritjes së borxhit të jashtëm të nënkuptuar prej tij (EJL6 Kutia III).

⁹ Shih Raportin e Bankës Botërore. 2015. *Doing Business 2015*, Washington DC.

¹⁰ Borxhi i jashtëm serb përfshin sigurimin e borxhit pas qershorit të 2014-ës.


¹¹ Është me vend të theksohet se të dhënat nga Banka Qendrore e Shqipërisë tregojnë për një borxh më të madh të jashtëm privat sesa është raportuar më parë në RRE-të e mëparshme të EJL6-ës. Edhe ky fakt ka pasur ndikim të lehtë në rritjen e borxhit të jashtëm mesatar rajonal.

Figura 12: Borxhi mesatar i jashtëm i EJL6-ës (përqindje e PBB-së)



Burimi: Bankat qendrore të EJM6-ës dhe ministritë e financave (MF)

Figura 13: Borxhi i jashtëm sipas shteteve të EJM6-ës (si përqindje PBB-je)



Burimi: Bankat qendrore të EJM6-ës dhe ministritë e financave (MF)
Shënim: Të dhënat nga viti 2014 përfaqësojnë të dhënat e fundit të disponueshme dhe jo domosdoshmërisht janë gjashtëmuore.

Kutia III. Qëndrueshmëria e llogarive korrente në ekonomitë e EJM6-ës

Megjithëse nuk ka një përkufizim absolut të qëndrueshmërisë së llogarive korrente, **deficiti i llogarive korrente të një vendi (CAD) mund të konsiderohet i qëndrueshëm për aq kohë sa raporti i borxhit publik me PBB-në nuk është në rritje dhe investitorët e huaj janë të gatshëm ta financojnë atë.** Qasja dominuese për vlerësimin e qëndrueshmërisë së llogarive korrente në literaturë është një qasje që ka ndikim mbi opsionet që mund të jenë të disponueshme në të ardhmen (Sachs 1981; Obsfeld dhe Rogoff 1994; Milesi-Ferretti dhe Razin 1996; IMF, 1998b; Carranza 2002), çfarë sugjeron që bilanci i llogarive korrente është pasojë e dinamikës largpamëse të kursimeve dhe të vendimeve për investime (Brissimis et al., 2010). Wu (2000) dhe Lau dhe Baharumshah (2005) i japin jetë këtij koncepti dhe sugjerojnë që një llogari korrente stacionare përkundëjt raportit të PBB-së është konsistente me raportin e borxhit të jashtëm me PBB-në, nuk shkon kurrë mbi një kufi të caktuar dhe që gjithmonë i kthehet këtij limiti. Wu (2000) konstaton një raport stacionar të llogarisë korrente përkundëjt PBB-së në përputhje me raportin përfundimtar të borxhit të jashtëm përkundëjt PBB-së për dhjetë shtete të OECD-së. Lau dhe Baharumshah (2005) konstatojnë një raport stacionar të llogarive korrente përkundëjt PBB-së për tre nga dymbëdhjetë shtetet aziatike. **Konstatimi i raportit ose stacionar ose në ulje të llogarive korrente përkundëjt PBB-së me kalimin e kohës përbën kusht të domosdoshëm, por jo të mjaftueshëm për qëndrueshmërinë e llogarive korrente.** Kjo gjendje nuk është e mjaftueshme pasi shumë faktorë kanë ndikim mbi qëndrueshmërinë e llogarisë korrente. Në veçanti, deficiti i llogarive korrente për të financuar investimet produktive nuk është i njëjtë me deficitin e llogarive korrente të përdorur për financimin e konsumit dhe për të pasur akses në çështjet e tregjeve ndërkombëtare financiare. Megjithatë, gjetja e një raporti të deficitit të llogarive korrente përkundëjt PBB-së që kthehet mbrapsht tek një nivel i pranishëm për një kohë të gjatë e ul rrezikun e një krize të llogarisë korrente. Në testojmë nëse raporti i llogarisë korrente përkundëjt PBB-së është stacionar për EJM6-ën. Gjatë vlerësimit të nivelit të konvergencës së llogarisë korrente drejt një gjendje të qëndrueshme ne ndjekim punën e Jandog dhe Shang-Jin (2007) dhe literaturën ekonomike për përlllogaritjen e konvergencës (Ball dhe Seridan, 2003; Hyvonen 2004).

Mbështetur në Wu (2000) dhe Lau dhe Baharumshah (2005), ne analizojmë nëse deficiti i vazhdueshëm i llogarisë korrente në shtetet e EJM6-ës është i qëndrueshëm. Ne jemi të mendimit se shtetet me deficite potencialisht të larta të llogarive korrente do të përjetojnë një ulje të deficitit të llogarive korrente vetëm duke ju kthyer disa vlerave mesatare të pranishme për shumë kohë në të gjithë vendin. Këto deficite do të kenë tendencë të ulen nëse përmasat e tyre kanë ardhur si rezultat i performancës fillestare të vendit për shkak të faktorëve tranzitorë dhe/ose performancës së dobët ekonomike. Kjo konvergencë mund të shfaqet si pasojë e politikës për t'u bërë pjesë e BE-së, pasi ne mendojmë se shtetet e EJM6-ës e dinë se futja në BE me deficite të larta të llogarive korrente nuk është i mundur.

Ne e testojmë qëndrueshmërinë e deficitit të llogarive korrente duke përdorur dy metoda të ndryshme. Metoda e parë është metoda e zakontë e më pak katrorëve dhe metoda e dytë është e metoda e regresionit të panelit. Metoda e

parë aplikohet veçmas për çdo shtet të rajonit. Metoda e dytë aplikohet mbi të gjitha shtetet e EJL6-ës në grup. Procedura e vlerësimit mbështeten në hapat e mëposhtme:

1. *Së pari* me llogarisim x_t që përfaqëson llogarinë korrente të çdo shteti (*ca*) si përqindje të PBB-së së tij (*gdp*) në

$$\text{periudhën (t): } x_t = \frac{ca_t}{gdp_t} \quad (1)$$

ku t indeksin vitet nga 2002-i deri në 2013-ën.

2. *Së dyti* ne testojmë nëse x_t ndjek një proces njësie bazë duke vlerësuar:

$$\Delta x_t = \alpha + \beta x_{t-1} + e_t \quad (2)$$

nëse $\beta = 1$ në ekuacionin (2), konvergjenca përjashtohet si përkufizim, pasi deficiti i llogarisë korrente do të jetë gjithnjë në rritje konvergjence¹². Megjithatë, nëse beta është më pak se 1, atëherë ajo është në përputhje me llogarinë korrente që konvergon drejt një gjendje të qëndrueshme. Sa më e ngushtë të jetë shpejtësia e konvergjencës ndaj vlerës absolute, aq më e shpejtë do të jetë shpejtësia e konvergjencës.

Rezultatet sugjerojnë se EJL6-a e marrë sëbashku ka një CAD të qëndrueshëm për një kohë të gjatë prej 9.8 përqind të PBB-së dhe që ajo do të konvergojë drejt këtij niveli, pavarësisht nëse PBB-ja është më e lartë ose më e ulët se ky nivel në çdo vit të caktuar (Tabela BIII.1). CAD-ja konvergon drejt gjendjes së saj të qëndrueshme për një kohë të gjatë në një nivel prej rreth 38 përqind në vit.

Tabela BIII.1: Gjendja e qëndrueshme për një kohë të gjatë dhe shpejtësia e konvergjimit për EJL6-ën

Parashikimi	Të dhënat vjetore
Gjendje e qëndrueshme për një kohë të gjatë	9.8 përqind
Shpejtësia e konvergjimit	38 përqind

Të dhënat na lejojnë po ashtu të bëjmë modelin veçmas për Bosnjen dhe Hercegovinën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbinë¹³. Këto shtete kanë CAD të qëndrueshëm prej përkatësisht 14, 7.9 dhe 14.1 përqind (Tabela BIII.2). Bosnja dhe Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia të gjitha shfaqin tendenca konvergjimi më të shpejta sesa mesatarja e EJL6-ës, me “shpejtësi” prej përkatësisht 77, 64 dhe 78 përqind në vit.

Tabela BIII.2: Gjendja e qëndrueshme për një kohë të gjatë dhe shpejtësia e konvergjimit për Bosnjën dhe Hercegovinën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbinë

Parashikimi	Bosnja dhe Hercegovina	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Serbia
Gjendje e qëndrueshme për një kohë të gjatë	14.0 përqind	7.9 përqind	14.1 përqind
Shpejtësia e konvergjimit	77.0 përqind	63.8 përqind	78.5 përqind

¹² Ekuacioni (2) është në fakt formë e testit të Dickey-Fuller (DF) për njësi bazë dhe nëse $\beta=1$ atëherë ka njësi bazë.

¹³ Kemi aplikuar testin **panel** per rrenjen njesi për të trajtuar çështjen e fuqisë së ulët të testeve standarde të testeve te rrenjes njesi. Rezultatet e testit të parë tregojnë se ne mund ta kundërshtojmë Ho-në e një procesi të zakonshëm për njësi bazë, por që nuk mund të kundërshtojmë Ho-në e një procesi individual të njësisë bazë. Kjo do të thotë që ne na u desh të testonim se cilat nga shtetet e EJL6-ës janë të përshtatshme për këtë qasje.


Parashikimi për gjendjen e qëndrueshme të CAD për një kohë të gjatë nuk duket se është i mundur për periudhën afatmesme deri në afatgjatë. Analizimi sugjeron që çdo shtet në EJL6 paraqet një nivel CAD-je të shtrirë për një kohë të gjatë dhe që është shumë mbi nivelin maksimal prej 5 përqind të raportit të CAD-së dhe PBB-së, që në diagnostifikimin e vulnerabilitetit ndonjëherë konsiderohet nivel i qëndrueshëm. Deficitet e llogarive korrente të vazhdueshme mbi nivelin 5 përqind të PBB-së përgjithësisht janë konsideruar si jo të qëndrueshme në kuadrin afatgjatë, veçanërisht kur deficitet financohen me borxh afatshkurtër dhe ulje të rezervave të huaja (Milesi-Ferretti dhe Razin, 1996, Carranza 2002). [Për më tepër, duhet të analizohet struktura e financimit e CAD-së.](#) Niveli i qëndrueshëm për një kohë të gjatë për Bosnje dhe Hercegovinën dhe Serbinë është shumë më i lartë sesa niveli i shteteve të tjera të EJL6-ës. Analiza paralajmëron po ashtu për një deficit të llogarive korrente potencialisht të paqëndrueshëm në këto shtete.

Tregu i punës

Rimëkëmbja nga recesioni i vitit 2012 ka pasur efekt të pakët mbi treguesit kyç të tregut të punës në EJL6. Që prej asaj kohe, punësimi i rajonit të EJL6-ës është rritur disi, papunësia është ulur pak, ndërsa nivelet e pjesëmarrjes së krahut të punës janë përmirësuar pak në pjesën më të madhe të ekonomive të rajonit (Figura 14). Numri i të punësuarve në të gjithë rajonin është rritur me 4 përqind në periudhën ndërmjet tremujorit të dytë 2012 dhe tremujorit të dytë të 2014-ës. Nivelet e rritjes pozitive kanë lënë pak gjurmë në nivelet e larta dhe të vazhdueshme të papunësisë, të cilat ranë nga mesatarja 24.1 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2012 në 22 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2014 (Figura 15). Si rezultat, është rritur pak niveli i pjesëmarrjes në tregun e punës nga 49.1 përqind në 50.3 përqind përgjatë të njëjtës periudhë.


Performanca e tregut të punës ka qenë e ndryshme në ekonomitë e rajonit. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka përjetuar përmirësim të kushteve të tregut të punës që prej vitit 2008. Ndërkohë, tregjet e punës në Malin e Zi dhe në Serbi, të cilat u prekën shumë nga kriza, kanë pësuar rimëkëmbje gjatë viteve të fundit ku nivelet e punësimit kanë arritur nivelet e periudhës përpara krizës në Malin e Zi. Në anën tjetër, në Bosnje dhe Hercegovinë, tregu i punës ka treguar vetëm ndryshime minimale gjatë periudhës së rimëkëmbjes. Në Shqipëri kushtet e tregut të punës janë përkeqësuar për shkak të rënies së nivelit të rritjes në vitin 2013. Megjithatë, rimëkëmbja e ekonomive të EJL6-ës rezultoi të ishte e brishtë dhe rritja u lëkund në gjysmën e parë të vitit 2014 për shkak jo vetëm të përmbytjeve në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, por edhe të mundësive të dobëta për rritje në ekonomitë e zhvilluara, kryesisht në Eurozonë. Tregjet e punës kanë të ngjarë të tregojnë efektet e uljes së rritjes me ca vonesë dhe të ngadalësojnë realizimin e reformave të punës në vendet që e kërkojnë ato, duke ndrydhur rritjen dhe uljen e papunësisë.

Figura 14: Punësimi në EJL6, T2 2008-T2 2014



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në të dhënat e zyrtare kombëtare të statistikave.

Figura 15: Nivelet e papunësisë në EJL6, T2 2008-T2 2014



Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave.

Sfidat strukturore i kanë prekur tregjet e punës në EJL6. Elasticiteti i treguesve kryesorë të tregut të punës lidhur me rritjen është i ulët në të gjithë EJL6-ën, duke treguar për ngurtësi strukturore të tregjeve të punës (Figura 16). Pavarësisht ndryshimeve ndërmjet vendeve dhe sektorëve të ndryshëm, në përgjithësi ngurtësitë reale të pagave e kanë lënë punësimin si kanal kryesor të rregullimit të tregut të punës në përgjigje të krizës (FMN 2014). Për shkak kryesisht të uljes së ngurtësisë reale të pagave, kostot për njësi pune nuk janë përshtatur gjatë krizës, duke e bërë EJL6-ën të humbë konkurrueshmërinë e saj. Tregjet informale të punës kanë vijuar edhe si rezultat edhe si burim i problemeve të tregut të punës. Dividendi i rritjes përkundrejt akumulimit të kapitali njerëzor ka qenë i ulët ose negativ dhe ka nxjerrë në pah rezultatin agregat të inefficencave që prekin tregjet e punës. Nivelet e pjesëmarrjes së tregjeve të punës në të gjithë EJL6-ën, veçanërisht ndërmjet popullsisë femra, kanë mbetur më të ulëta se ato të popullsisë meshkuj, ashtu si edhe në BE (Figura 17). Nivelet e vazhdueshme të papunësisë së lartë kanë pasur ndikimet e tyre posaçërisht tek të rinjtë në EJL; papunësia tek të rinjtë ka arritur nivelin mesatar prej 50 përqind.

Figura 16: Papunësia dhe rritja e PBB-së, 1993-2011





Figura 17: Nivelet e pjesëmarrjes së krahut të punës në EJL6, T2 2014



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe Eurostat-i.

Rregulloret e tregut të punës, të matura nga Treguesit e Të Bërit Biznes, kanë hapësira për përmirësim. Ka shtete në rajon, si, për shembull, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, që ka praktika më fleksibël punësimi sesa shtetet e tjera, ose shtete relativisht me më shumë përparim për sa i përket trajtimit të ngurtësive të tregjeve të punës gjatë viteve të fundit (Figura 18). Ndërsa ashpërsia agregate e indeksit të punësimit nuk sugjeron tregje posaçërisht kufizuese të tregut të punës në EJL6, nënkomponentët tregojnë një tjetër situatë. Për shembull, paga minimale përkundrejt vlerës së shtuar për punonjës është më e lartë se mesatarja e BE-së, veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Shqipëri, duke çuar në vështirësi për

vendimet për punësim (Figura 22, Figura 20). Nga ana tjetër, rregullat që mbulojnë orët e punës duket se janë fleksibël lidhur me rregullat e BE-së (Figura 19). Rregullat e lidhura me heqjen nga puna paraqesin një pamje të ngatërruar, dhe duket se janë më strikte në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kosovë sesa në ekonominë e tjera të rajonit (Figura 21, Figura 23, Figura 24). Po ashtu, kostot e heqjes nga puna janë më të larta në ekonomi të caktuara të rajonit sesa në BE. Për shembull, periudha e njoftimit dhe pagimi i detyrimeve për shkarkimet nga puna janë ende të larta në Shqipëri, megjithëse këto kosto kanë rënë shumë gjatë viteve të fundit duke ndjekur tendencën e rajonit.

Figura 18: Të Bërit Biznes – ngurtësia e punësimit, 2008-14





Figura 19: Ngurtësia e orëve, 2008-14



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).

Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).

Figura 20: Të Bërit Biznes – vështirësia në të marrët në punë, 2008-14






Figura 21: Vështirësia për shkarkimin nga puna, 2008-14



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).


Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).

Figura 22: Të Bërit biznes- paga minimale, 2008-14




Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).

Figura 23: Periudha e njoftimit për shkarkim nga detyra, 2008-14



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).

Figura 24: Dëmshpërblimi për shkarkimin nga detyra, 2008-14



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në treguesit e Të Bërit Biznes (2008 dhe 2014).

Financat dhe borxhi publik


Deficiti mesatar në EJL6 vlerësohet të jetë rritur me 0.4 përqind e PBB-së duke kapur nivelin e 4.2 përqind në vitin 2014 për shkak të rritjes së më të shpejtë të shpenzimeve sesa të të ardhurave. Shpenzimet pritet të jenë rritur si përqindje e PBB-së në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, por të jenë ulur disi në tre shtetet e tjera të EJL6-ës (Figura 29). Rindërtimi pas përmbytyjeve ka të ngjarë të kontribuojë për rritjen e shpenzimeve në Bosnje dhe Hercegovinë. Në Shqipëri, rritja e shpenzimeve qeveritare përfshin shlyerjen e pagesave të prapambetura të qeverisë prej 2.5 përqind të PBB-së. Rritja e të ardhurave nga tatimet gjatë vitit deri në shtator në të gjitha shtetet e EJL6-ës (përveç Kosovës) nuk ishte në gjendje të kompensonte rritjen e shpenzimeve publike (Figura 25 dhe 26). Të ardhurat mesatare pritet të jenë rritur me 0.8 përqind të PBB-së në të gjitha shtetet e EJL6-ës, përveç Kosovës (Figura 28).

Njëra nga dy entitetet e Bosnjës dhe Hercegovinës (Republika Serbe) i rriti kontributet e sigurimeve shoqërore me 3 pikë përqindje për të paguar një fond solidariteti të synuar për përdorim për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytyjet, duke kontribuar kështu për një nivel më të lartë të ardhurash. Në Shqipëri, të ardhurat më të larta tatimore kanë kontribuar për rreth gjysmën e uljes së deficitit tregtar gjatë tre tremujorëve të parë të 2014-ës, dhe në Serbi për më shumë se një të tretën e deficitit tregtar. Në Kosovë dhe në Mal të Zi ulja e shpenzimeve, dukshëm në buxhetin kapital, ka çuar po ashtu në uljen e deficitit.

Performanca individuale e shteteve të EJL6-ës ka qenë e ndryshme në vitin 2014 (Figura 26). Rritja më e madhe e deficitit parashikohet në Bosnje dhe Hercegovinë. Pritet që atje deficiti fiskal të jetë rritur nga 1.9 deri në 4.5 përqind të PBB-së deri në fund të 2014-ës në kurriz të rritjes së madhe të shpenzimeve (Figura 27). Ulja më e madhe është parashikuar në Mal të Zi, ku kombinimi i rritjes së të ardhurave me uljen e shpenzimeve pritet të ketë ulur deficitin nga 3.3 deri në 0.7 përqind të PBB-së. Deficiti fiskal në Serbi pritet të jetë rritur nga 5.6 përqind e PBB-së në 7.9, një nivel i paqëndrueshëm dhe më i larti në EJL6.

Rajoni i EJL6-ës është ndarë në dy grupe shtetesh: shtetet me qeveri “të mëdha” dhe shteteve me qeveri “të vogla”. Me shpenzimet publike ndërmjet 45 dhe 50 përqind të PBB-së (dhe, për pasojë, fatura të larta tatimore) shteti dominon thuajse gjysmën e ekonomisë në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi. Këto shtete kanë paga dhe përfitime sociale të larta të papërbalueshme për sektorin publik. Një pjesë e


Figura 25: Ndryshimi i përqindjes në deficitin fiskal në janar – shtator, 2013-14



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore bazuar në Ministrinë e Financave.


këtyre pagave janë të targetuara keq, pasi pjesa më e madhe e shumave të mëdha iu shkon familjeve më të pasura.¹⁴

Figura 26: Deficiti fiskal, 2013-14




Burimi: Ministrinë e Financave dhe parashikimet e Bankës Botërore

Figura 27: Kontributi për ndryshimin e deficitit, 2014




Burimi: Ministrinë e Financave dhe parashikimet e Bankës Botërore

Figura 28: Të ardhurat, 2013-14



Burimi: Ministrinë e Financave dhe parashikimet e Bankës Botërore

Figura 29: Shpenzimet, 2013-14




Burimi: Ministrinë e Financave dhe parashikimet e Bankës Botërore

¹⁴ Për më shumë detaje, shihni Bankën Botërore. 2014. *Raporti i Rregullt Ekonomik për Evropën Juglindore, Seria 5*. Washington DC.

Shtetet që kanë pasur mundësinë të ulin shpenzimet në vitin 2014, e kanë bërë këtë gjë kryesisht duke ulur investimet kapitale, një model që është vënë re gjatë periudhës pas krizës në të gjithë rajonin dhe një situatë që ngre shqetësime për rritjen ekonomike në periudhën mesatare. Në vitin 2008, pak para krizës globale ekonomike, shpenzimet kapitale publike kanë arritur pikun në shumë prej shteteve të rajonit me mesataren prej 7.3 përqind të PBB-së. Me krizën dhe në kushtet e uljes së të ardhurave, ngurtësimet e shumta në shpenzime si rezultat i shpenzimeve për faturat e stërmëdha të pagave dhe pensione, qeveritë shkurtuan shpenzimet kapitale në përpjekje për të përmbajtur zgjerimin e deficiteve fiskale (Figura 30). Deri në fund të 2013-ës, mesatarja e shpenzimeve kapitale publike ra në nivelin 5.4 përqind të PBB-së. Rëniet ishin veçanërisht domethënëse në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Në rastin e Malit të Zi, shpenzimet kapitale publike ranë me mesatarisht 4 përqind të PBB-së. Në nivelin e 2.1 përqind të PBB-së, Serbia shënjoi nivelin më të ulët të shpenzimit kapital në të gjithë rajonin e EJK6-ës në vitin 2013. Shkurtimeve e shpenzimeve kapitale vijuan përgjatë të gjithë 2014 – me shkurtimeve që arritën në 43 përqind në terma nominalë në Shqipëri, me efekte potenciale mbi perspektivën e rritjes afatmesme dhe afatgjatë. Vetëm Kosova ka pasur rritje të shpenzimeve kapitale që prej vitit 2008, rritje e cila është konsumuar kryesisht nga një investim i vetëm i madh për ndërtimin e një rruge dhe ekzekutimi i buxhetit të Kosovës në 2014-ën mbeti i dobët për shkak të vonesës prej më shumë se 5 muajsh për formimin e qeverisë së re.

Figura 30: Shpenzimet publike kapitale % PBB, 2008-13



Burimi: Ministrinë e Financave dhe Eurostat-i.

Edhe niveli ekzistues i investimeve kapitale jo gjithmonë rezulton të drejtohet drejt zonave me kthimet më të larta ekonomike. Autostradat e reja tërheqin investimet në disa shtete, duke përjashtuar potencialisht investime të tjera me përfitime më të mëdha, ndërsa rrisin borxhin publik deri në nivele shqetësuese. Për shembull, autostrada e ndërtuar kohët e fundit në Kosovë drejt Durrësit në Shqipëri mund të ketë mënjeluar projekte të tjera rrugore dhe mirëmbajtje rrugë me nivele më të larta kthimi ekonomik (shih Analizën e Financave Publike¹⁵). Në Malin e Zi, një autostradë e re vlerësohet të kushtojë rreth 25 përqind e PBB-së, do të financohet nga huadhënia e jashtme dhe do të rrisë ndjeshëm deficitet fiskale dhe borxhin publik në kuadrin afatmesëm. Për më tepër, kostoja e ndërtimit pritet të rritet më tej për shkak të taksave të ndryshuara pas miratimit të një ligji të ri ku importet e materialit të ndërtimit, pajisjeve dhe mallrave të tjera përjashtohen nga doganat dhe TVSH-ja. Ndryshimet lejojnë po ashtu dhe përjashtimet e punonjësve jo nënshtetas ose që nuk janë banorë të përhershëm në vend nga PIT-ja dhe kontributet sociale për të ardhurat e fituara në Malin e Zi dhe propozon tarifë akcize tre herë më të ulët (169 euro për ton).


¹⁵ Banka Botërore. 2014. *Analizimi i Financave Publike të Kosovës: Politikat fiskale për një komb të ri*. Washington, DC

Borxhi publik vlerësohet të jetë rritur me 3 përqind të PBB-së në vitin 2014, duke e rritur nivelin mesatar të borxhit në 52.3 përqind të PBB-së. Ky nivel përfaqëson një rritje të vazhdueshme që prej fillimit të krizës globale. Në fund të vitit 2014, raporti mesatar i borxhit publik përkundrejt PBB-së në EJL6 u vlerësua të ishte rritur me thuajse 18 përqind të PBB-së që prej vitit 2009 pasi financat publike u përkeqësuan ndjeshëm. Vetëm në vitin 2012 (kur ekonomitë e EJL6-ës u kontraktuan me 0.6 përqind dhe deficitin mesatar fiskal arriti 3.4 përqind të PBB-së), borxhi publik i EJL6-ës u rrit me 6.7 përqind të PBB-së (kryesisht për shkak të deficiteve fiskale, por edhe duke reflektuar një performancë të dobët rritjeje). Ndërsa rimëkëmbja në vitin 2013 i ndihmoi qeveritë të kufizonin rritjen në nivelet e borxhit, progresi i ngadaltë në konsolidimin fiskal ishte faktor kryesor pas akumulimit të borxhit në periudhën 2013-14. Si rezultat, raporti mesatar i borxhit publik përkundrejt PBB-së në EJL6 u rrit nga 47.1 përqind të PBB-së në vitin 2012 në 49.3 përqind të PBB-së në vitin 2013, dhe vlerësohet të ketë arritur rreth 52.3 përqind të PBB-së në vitin

2014. Të gjitha ekonomitë e rajonit janë në përputhje me këtë tendencë të përgjithshme në nivele të ndryshme, me përjashtim të Shqipërisë dhe të Kosovës. Në Shqipëri ngadalësimi i aktivitetit ekonomik dhe rritja e pagesave të prapambetura publike ka rritur në mënyrë të konsiderueshme nivelet e borxhit në vitin 2013. Kosova e ka akumuluar borxhin publik me ritëm të shpejtë pas vitit 2011 (Figura 31).


Nivelet aktuale të borxhit publik janë kryesisht shqetësuese në gjysmën e ekonomive të rajonit. Raporti i borxhit publik përkundrejt PBB-së qëndron mbi pragun 60 përqind në Shqipëri, Malin e Zi, dhe Serbi që prej tremujorit të dytë të 2014-ës (Figura 32). Në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë borxhi publik e ka tejkalluar nivelin 40 përqind të PBB-së. Pas emetimit të obligacionit prej 500 milionë eurosh në korrik të vitit 2014, borxhi publik i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë u rrit në mbi 46 përqind të PBB-së. Kosova ka ende nivel të ulët të borxhit publik, por tendencat e fundit shfaqin shqetësime për rrugën e saj në të ardhmen. E njëjta situatë është e ngjashme dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Figura 31: Tendenca e borxhit publik, 2009- 2014



Burimi: Ministrinë e Financave dhe parashikimet e Bankës Botërore.

Figura 32: Borxhi publik, T2 2014




Burimi: Ministrinë e Financave.

Komponenti i brendshëm i borxhit publik është rritur pas vitit 2011. Borxhi publik si përqindje e PBB-së ka qëndruar thuhet në nivel të pandryshueshëm në periudhën ndërmjet vitit 2009 dhe 2011, ndërsa financimi i jashtëm, veçanërisht nga donatorët ndërkombëtarë, është rritur (Figura 33). Si rezultat, përqindja e financimit të brendshëm në totalin e borxhit publik ka rënë nga 42.1 përqind në vitin 2009 në 36.6 përqind në vitin 2011. Ndërkohë që qeveritë filluan të preknin më shumë burimet e financimit të brendshëm pas vitit 2011, përqindja e financimit të brendshëm në financimin e përgjithshëm qeveritar u rrit me 39.2 përqind në gjysmën e dytë të vitit 2014.

Sistemet e menaxhimit të financave publike nuk janë ende tërësisht të zhvilluara në EJL6. Gjendja aktuale e sistemeve të menaxhimit të financave publike i bën proceset e përgjithshme të menaxhimit të financave publike dhe të borxhit më pak transparente dhe më shumë të prekshme nga deficitet dhe/ose borxhet e fshehura. Për më tepër, nivelet në rritje të financimit të brendshëm pa kontroll efektiv i bëjnë ekonominë të ndjeshme ndaj rreziqeve të ndërlidhura, pasi bilancet e sektorit publik dhe financiar janë të lidhura me njëri-tjetrin.


Rritjet e niveleve të interesit në të ardhmen do të rrisin rrezikun e qëndrueshmërisë fiskale, duke e bërë përmirësimin e menaxhimit të borxhit publik nevojë të rëndësishme për ekonominë e EJL6-ës. Ndërsa niveli mesatar efektiv i borxhit publik të EJL6-ës është rritur në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013, eksperiencat specifike të vendit janë diversifikuar (Figura 34). Shqipëria, për shembull, ka përfituar nga ulja e niveleve të interesit pas vitit 2010. Nga ana tjetër, Serbia, dhe në nivel më të pakët edhe Mali i Zi, patën nivele interesi që u rritën shumë shpejt ndërsa ata aksesonin tregjet ndërkombëtare kapitale, ndër të tjera. Rritja e borxhit publik, e shoqëruar me klimën financiare të paqëndrueshme e bën të rëndësishëm menaxhimin e mirë të portofolave të borxhit. Këtu përfshihet monitorimi me kujdes i obligacioneve të mundshme (si, për shembull, ndërmarrjet shtetërore), bërja e përzgjedhjeve pas marrjes së informacionit të plotë për rreziqet, dhe fitimi i besimit në treg duke nxjerrë strategji të qarta për menaxhimin e borxhit dhe kalendare ankandesh.

Figura 33: Borxhi publik i EJL6-ës sipas rezidencës/vendqëndrimit, 2009-T2 2014



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në të dhënat e Ministrive të Financave.

Figura 34: Indekset e normave efektive të interesit mbi borxhin publik, 2007-13 (2007=100)



Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore mbështetur në të dhënat e Ministrive të Financave.


Në përgjithësi, ka pak ose aspak hapësirë fiskale për të ndihmuar stimulimin e kërkesës dhe nxitjen e rritjes ekonomike afatshkurtër në EJL6. Me borxhin e lartë publik në disa shtete, borxhin publik që po rritet shpejt në disa shtete të tjera dhe me tre shtete me sektorë publikë më të mëdhenj sesa shumë prej shteteve të BE-së, duket se ka pak hapësirë për rritje të shpenzimeve publike për të nxitur rritjen ekonomike. Mund të kërkohet konsolidim i mëtejshëm dhe shpenzim “më i zgjuar” për projekte të synuara dhe të përqendruara tek nxitja e rritjes (në vend të, për shembull, përfitimeve sociale të etiketuara keq) për të arritur pozicione të qëndrueshme financiare dhe për të rritur potencialin e rritjes.

Inflacioni, politikat monetare dhe të këmbimit valutor

Çmimet më të ulëta të mallrave të importit dhe produkti nën potencial kanë shkaktuar rënien e inflacionit nga mesatarisht 4.3 përqind në vitin 2013 në 0.9 përqind në nëntëmujorin e vitit 2014. Pas rënies domethënëse në vitin 2013, inflacioni mesatar vjetor arriti në 1.1 përqind në fund të shtatorit të 2014-ës. Ulja e çmimeve ndërkombëtare të naftës dhe ushqimeve dhe transmetimi i kësaj rënieje dhe tek shtetet e EJL6-ës çoi në shtrirjen e inflacionit të ulët, ose deflacionit, në EJL përgjatë të gjithë vitit 2014. Kontributet më të larta të uljeve të çmimeve të ushqimit tek inflacioni janë vënë re në Serbi, ku thuhet se 60 përqind e CPI-së e rënë që prej fillimit të vitit 2013 mund të shpjegohet me ndikimin deflacionar mbi çmimet e ushqimeve. Boshllëqet e rezultateve, të kombinuara me kërkesën e ulët agregate kanë dhënë po ashtu ndihmën e tyre për mbajtjen e çmimeve të ulëta.

Zhvillimet e inflacionit kanë qenë heterogjene në të gjithë rajonin. Bosnja dhe Hercegovina ranë në deflacion në gusht të 2013-ës, ndërsa Mali i Zi dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë u futën në territorin e inflacionit negativ në fillim të vitit 2014 (Figura 35). Çmimet e konsumit në Shqipëri dhe në Serbi, të vetmet shtete me fleksibilitet politikash financiare, ranë përkatësisht në nivelin 1.5 përqind dhe 2.1 përqind në fund të shtatorit. Kosova ka përbërë përjashtim, pasi ajo ka shënuar një rritje graduale në inflacion, nga 0.2 përqind në fillim të vitit në 1.4 përqind në shtator (me mesataren vjetore prej 0.6 në tetor). Përveç niveleve shumë të ulëta në EJL6, inflacioni është më i lartë sesa në shtetet e BE11-ës dhe BE15-ës (Figura 36).


Figura 35: Inflacioni i ICK, përqindja (krahasimi me të njëjtën periudhë të një viti më parë)



Shënim: EJL6-a si mesatare e ponderuar.

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Figura 36: Krahasimi i inflacionit të ICK në rajon, në përqindje (krahasimi me të njëjtën periudhë të një viti më parë)




Shënim: Inflacionet e rajonit të mbështetura tek mesataret e vendeve.

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Rënia e çmimeve ndërkombëtare të artikujve kryesorë bujqësorë, shoqëruar nga kërkesa e brendshme e ulët, e ka ulur presionin e rritjes së çmimeve të artikujve ushqimorë për shkak të përmbytjeve të majit. Pas thaujse një viti tendence uljeje, çmimet e ushqimeve filluan të rriteshin në bazë vjetore në tremujorin e tretë të 2014-ës dhe përfundimisht u bënë pozitive në shtator (Figura 37). E kundërta ka ndodhur me çmimet e energjisë, të cilat u përkeqësuan për shkak të efektit bazë të rritjes së çmimit të rregulluar të energjisë elektrike dhe derivateve të naftës një vit më parë në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe çmimet e energjisë elektrike për familjarët në Serbi (Figura 38). Në Kosovë, çmimet e rregulluara të energjisë u rritën për shkak të problemeve ekzistuese për një kohë të gjatë në vend për plotësimin e kërkesës për energji dhe veçanërisht pas shpërthimit të një impianti për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë në qershor të vitit 2014, i cili pati ndikim mbi kapacitetet e brendshme prodhuese.


Figura 37: Inflacioni në artikujt ushqimorë, përqindje (krahasimi me të njëjtën periudhë të një viti më parë)



Shënim: Mesatarja e ponderuar e EJL6-ës.

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Figura 38: Inflacioni i çmimit të energjisë, përqindje (krahasimi me të njëjtën periudhë të një viti më parë)



Shënim: Mesatarja e ponderuar e EJL6-ës.


Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Në kuadrin e inflacionit të ulët dhe deflacionit në shtetet e EJL6-ës, bankat qendrore në Shqipëri dhe në Serbi i lehtësuan më tej politikat monetare për të ulur presionet për likuiditet. Në vitin 2014, disa banka kombëtare i shkurtuan nivelet bazë të interesit më shumë se një herë. Bankat qendrore në Serbi dhe në Shqipëri e shkurtuan nivelin e interesit me përkatësisht 150 dhe 75 pikë bazë në periudhën nga janari deri në nëntor të vitit 2014 (Figura 39). Pas tre shkurtimeve, në shkurt, maj dhe nëntor, nivelet bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë arritën nivelin rekord të ulët në 2.25 përqind në nëntor. Edhe Serbia e ka ulur nivelin zyrtar të politikave me 0.5 përqind në maj dhe po në të njëjtin nivel në nëntor në nivelin 8 përqind, me uljen e nivelit real të interesit pavarësisht moderimit të inflacionit. Megjithëse bankat qendrore në Serbi dhe Shqipëri kanë regjime fleksibël të këmbimeve valutore, diskrecioni i tyre kufizohet nga borxhet relativisht të larta të marra në monedhë të huaj (rreth 70 përqind në Serbi dhe 50 përqind në Shqipëri). Komiteti për Politikat Monetare në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, pas vlerësimit të qëndrimit të politikave të saj monetare si adekuate, e la të pandryshuar nivelin e politikave në vitin 2014. Shtetet që përdorin euron, ose e fiksojnë monedhën e tyre të brendshme sipas vleftësimit të euros, të tilla

si Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova, nuk i ndryshuan politikat e tyre monetare në vitin 2014 pas uljes së niveleve të kërkesës për rezerve në vitet e fundit. Në Shqipëri, niveli i këmbimit kundrejt euros ka qenë i qëndrueshëm, pavarësisht regjimit me rrjedhje të lirë. Lehtësimi i mëtejshëm i politikës monetare dhe ulja për pasojë e nivelit të interesit në depozita dhe letra me vlerë në monedhë lokale mund të çojnë në ndryshime portofolash në posedimet në monedhë të huaj. Ndryshimet e menjëhershme të kursit të këmbimit valutor mund të kenë ndikim negativ tek sistemi bankar, për shkak të dominancës së huadhënies në monedhë të huaj nga strukturat e portofolave të bankave.


Megjithatë, ky stimul monetar nuk e ka përshpejtuar rritjen e kreditimit, pasi kërkesat e ulëta për kreditim dhe shqetësimet e lidhura me cilësinë e portofolit mbeten ende të pranishme. Për të rritur mbështetjen për kreditimin për sektorin e biznesit të madh dhe për të ulur koston e huamarrjes për të, Banka Kombëtare e Serbisë (NSB) liroi një pjesë të potencialit të bankave për kreditim duke e ulur kërkesën për rezervë në kapital të huaj me 1 pikë përqindje në nëntor dhe duke e ulur sërish në të njëjtin nivel në dhjetor (në 27 përqind dhe 20 përqind, në varësi maturimit/përmbushjes së afatit). Në të njëjtën kohë, NBS-ja ngriti përqindjen e monedhës së brendshme në fondet rezervë të kërkuara në monedhë të huaj me 2 pikë përqindje në nëntor dhe me 2 pikë të tjera sërish në dhjetor (nga 32 përqind dhe 24 përqind në 36 përqind dhe 28 përqind), me synim inkurajimin e bankave për t'u mbështetur më shumë tek burimet e financimit në dinar në kuadrin afatgjatë.

Figura 39: Normat baze të interesit të politikave monetare (%)



Burimi: ECB-ja, Zyrrat kombëtare të statistikave.

Figura 40: Oerta e parase se gjërë, Indeksi (2009:3M1=100)




Burimi: FMN-ja, IFS-ja, ECB-ja, Eurostat-i, bankat qendrore kombëtare

Sektori financiar


Deri në mes të 2014-ës, niveli mesatar i EJL6-ës për huatë e këqija u rrit me 16.7 përqind të totalit të huave, nivel ky tre herë më i lartë se periudha para krizës. Të gjitha shtetet e EJL6-ës janë përballur me tendencën në rritje të huave të këqija, me përjashtim të Malit të Zi, ku huatë e këqija u ulën nga piku 25 përqind në fillim të vitit 2011 në 16.5 përqind në tetor të vitit 2014 (Figura 41).¹⁶ Por, nga ana tjetër, në pjesën tjetër të shteteve të EJL6-ës, në Shqipëri dhe në Serbi, për shembull, të cilat kanë nivelin më të lartë të huave të këqija në të gjithë rajonin, huatë e këqija kanë ndryshuar vetëm pak krahasuar me nivelet më të larta të tyre. Në Serbi, niveli aktual i huave të këqija është edhe më i lartë se gjatë krizës, pavarësisht një rënie të lehtë në gjysmën e parë të vitit 2014.

Figura 41: Huatë e këqija



Burimi: Autoritetet kombëtare dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

Figura 42: Niveli i rritjes së kreditimit



Burimi: Autoritetet kombëtare dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

Shënim: Niveli mesatar i rritjes për periudhën 2003-2005 për Shqipërinë dhe Malin e Zi, dhe për periudhën 2004-2005 për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Për shkak të harmonizimit të kontabilitetit me SNRF-të, të dhënat për Malin e Zi nga 2010-a dhe në vijim nuk janë të krahasueshme.

Nivelet e larta të huave të këqija, ndërmjet faktorëve të tjerë të ofertës dhe kërkesës, e kanë ndrydhur rritjen e kreditimit. Ngushtimi i standardeve të kreditimit dhe përkeqësimi i mëtejshëm i kushteve të financimit të bizneseve kryesore për degë të tyre kanë krijuar stres në kreditim në të gjithë rajonin, ku bankat e huaja luajnë rol dominues.¹⁷ Për më tepër, rritja ekonomike e dobët dhe e brishtë, e shoqëruar me mosdhënien e vazhdueshme të kredive, e ka ulur kërkesën për kredi. Si rezultat, në Serbi, Shqipëri dhe Malin e Zi, ka pasur tkurrje të kreditimit gjatë gjysmës së parë të 2014-ës, ndërsa rritja e kreditimit në


¹⁶ Ulja ka ardhur kryesisht si rezultat i “shitjes me shumicë” të huave të këqija në vitin 2011 dhe 2012.

¹⁷ Një sondazh i kohëve të fundit tregon se kushtet e huadhënies në tregjet e reja evropiane janë shtrënguar në tremujorin e tretë të 2014-ës pas përmirësimit të lehtë në tremujorin e dytë të 2014-ës. Instituti i Financës Ndërkombëtare, Sondazhi për Kushtet e Huadhënies së Bankave në Tregjet e Reja – tremujori i tretë i 2014-ës.

Bosnje dhe Hercegovinë mbeti ende e ulët me mesatarisht 3-4 përqind (Figura 42). Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë është i vetmi vend që ka pasur një rritje domethënëse të kreditimit (për shkak të rritjes së huadhënies për sektorin e biznesit të madh) ndërsa ekonomia vazhdoi të fuqizohej.


Ulja e raportit hua me depozita ka reflektuar rritjen e ngathët të kreditimit. Depozitat, të cilat u rritën me 9 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014 (krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë) kontribuan po ashtu dhe për uljen e raportit mesatar hua depozitë në vendet e EJL6-ës, nivel i cili ishte rreth 98 përqind në mes të vitit. Në nivelin 136 përqind në shtator të vitit 2014, Serbia pati raportin më të lartë në rajon, duke nënvizuar varësinë tek financimi i degës kryesore. Edhe Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi kanë pasur raporte hua me depozita më të larta se 100, duke arritur përkatësisht nivelin 116 dhe 111 në mes të vitit 2014 (Figura 43).

Figura 43: Raporti hua depozita



Burimi: Autoritetet kombëtare dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

Figura 44: Kthimi mbi aktivet (RoA), mesatarja tremujore




Burimi: Autoritetet kombëtare dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

Fitimi i bankave tregtare mbeti më i ulët sesa nivelet përpara krizës. Kthimi mesatar i aktiveve (RoA) në EJL6 është rritur nga 0.5 përqind në thujse 1 përqind në mes të vitit 2014, por vijon të jetë më i ulët sesa nivelet përpara krizës (Figura 44). Ulja e fitimit është më e dukshme në sektorin financiar të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë. Serbia është ngërthyer nga nivelet më të larta të huave të këqija dhe raportit hua depozitë në të gjithë rajonin dhe është në recesion.

Nivelet e likuiditetit dhe kapitalit nuk paraqesin shqetësime të menjëhershme. Nivelet e larta të likuiditetit dhe të kapitalit në EJL6 janë përgjigje e paqëndrueshmërisë së prurjeve financiare dhe pasigurisë së financimit nga bankat mëmë, ose daljes së mundshme prej tyre. Në këtë situatë, likuiditeti i përgjithshëm në sistemin financiar, që është diku ndërmjet 19 dhe 33 përqind të aktiveve të përgjithshme, duket i përshtatshëm (Figura 45). Mjaftueshmëria e kapitalit në sistem ka arritur mesataren e 17.2 përqind në mes të vitit 2014 dhe është larg kërkesave ligjore të 8-11 përqind (në varësi të ekonomisë), e cila duhet të jetë e mjaftueshme për të thithur rreziqet e identifikuara në sistem (Figura 46). Megjithatë, ka xhepa


vulnerabiliteti më të madh ndërmjet bankave individuale. Për më tepër, rritja e huave të këqija dhe provizionet përkatëse mund të gërryejnë mbrojtjet e kapitalit të bankave në të ardhmen.

Figura 45: Raporti i likuiditetit



Burimi: Vlerësime të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Figura 46: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Vlerësime të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.


Shënim: Të dhënat për Serbinë për Raportin Mesatar Tremujor të Mjaftueshmërisë së Kapitalit për periudhën 2006-2008 i referohen vetëm 2008-ës. Për shkak të harmonizimit të kontabilitetit me SNRF-të, të dhënat për Malin e Zi nuk janë të krahasueshme.

Rreziqet kryesore që kanosin sektorin financiar vijnë si rezultat i zgjidhjes së ngadaltë të huave të këqija dhe varësisë të lartë tek bankat mëmë. Nëse nuk trajtohen, huatë e këqija do të vijojnë të ngarkojnë bilancet e bankave, duke cënuar fitimet dhe kapitalin, dhe duke ndrydhur interesat e bankave në huamarrje të re dhe më përgjithësisht në aftësinë e bankave për të ushtruar ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Plus, aksesit i kufizuar tek financimi i jashtëm, vulnerabiliteti i disa bankave dhe ligështimi i zgjatur në zonën e euros përbëjnë të gjitha rreziqe për një rimëkëmbje të qëndrueshme ekonomike.

Dobësitë në sistemin ligjor pengojnë aftësinë e bankave për të mbledhur këstet nga huamarrësit që e kanë për detyrë të paguajnë dhe të realizojnë kolateralin. Ka disa pengesa të rëndësishme për zgjidhjen e situatës me huatë e këqija, duke përfshirë: (i) dobësitë në regjimin e aftësisë paguese të bizneseve të mëdha dhe kredituesve; (ii) paqartësitë ligjore lidhur me shitjen e huave të këqija, (iii) ligjet tatimore që dekurajojnë ristrukturimin, fshirjen ose shitjen e huave të këqija, dhe (iv) mungesa e një kuadri të mjaftueshëm ligjor për ristrukturimin e borxhit të bizneseve të mëdha jashtë gjykatave.


Degët e bankave të huaja varen nga mbështetja e bankës mëmë, gjë e cila e bën sistemin të cenueshëm ndaj zhvillimeve të jashtme. Bankat e huaja nga eurozona dominojnë sektorin financiar në EJL6¹⁸ (Kutia IV e EJL6-ës). Me përjashtim të Serbisë, aktivet e sektorëve financiarë të EJL6-ës kanë rreth 80-90 pronësi të huaj. Financimi i huaj i EJL6-ës vijoi të ulet (Figura 47). Gjatë gjysmës së parë të 2014-ës, bankat që raportojnë BIS-in kanë ulur në mënyrë të ndjeshme ekspozimin përtej kufijve me 0.6 përqind të PBB-së, krahasuar me uljen prej 0.45 në tremujorin e katërt të 2013-ës. Në nivel vendi, vazhdojnë të ekzistojnë divergjenca të konsiderueshme, ku Bosnja dhe Hercegovina dëshmojnë për uljet më të mëdha (Figura 48).

Figura 47: Financimi dhe kostot e financimit për EJL6-ën.



Burimi: Bloomberg, Bloomberg, Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS) dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

Figura 48: Pretendimet ndërkufitare të BIS-it, 2013: 6M2-2014: 3M2 (ndryshimi i përqindjes së PBB-së në 2013-ën, këmbimi i rregulluar valutor)



Burimi: Statistikat bankare të BIS-it dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

¹⁸ Banka austriake Hypo Alpe Adria ra dakord t'ia shiste aksionet e njësisë bankare të EJL6-ës në Ballkan kompanisë private amerikane Advent International dhe BERZh-it për një shumë e cila nuk është bërë e ditur. Aksionet e EJL6-ës, nëpërmjet të cilave zotërohen 7 banka në Slloveni, Kroaci, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, vlerësoheshin në 8.5 miliardë euro asetë në fund të qershorit. Vlera e regjistruar e tyre ra me 500 milionë euro në vitin 2013. Shitja duhet të miratohet nga qeveria austriake, ish pronari i mëparshëm i Hypo-s BayernLB, si dhe nga BERZh-i dhe Advent-i.

Kutia IV. Financimi i sistemit bankar të EJL6-ës

Modeli bankar përpara krizës në EJL6 mbështetej tek prania e madhe e bankave të huaja dhe tek varësia e madhe e financimit nga bankat mëmë (në përjashtim të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë). Ndërsa zhvillimi i sektorit bankar në shtetet e EJL6-ës ishte i ndryshëm në periudhën përpara krizës të vitit 2003-2008, mund të identifikohen disa tendenca të përbashkëta, përfshirë dhe vazhdimin e thellimit të sektorit financiar, konsolidimin e sektorit bankar dhe ndryshimin drejt sektorëve bankarë privatë me rritje të pronësisë së huaj. E nxitur nga një mjedis beninj global dhe huadhënie të mjaftueshme të mbështetur nga financimi i bankave mëmë dhe kapitalit të degëve, kreditimi i sektorit privat u rrit në nivele përtej 30 përqind në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2005. Si pasojë, raportet hua depozitë në banka arritën pikën maksimale 120-170 përqind në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.

Dobësitë e lidhura me këtë sistem u bënë të qarta gjatë krizës globale financiare kur u ndaluan prurjet kapitale. Si rezultat i krizës, prurjet kapitale në shtete e EJL6-ës u tjetërsuan dhe pengesat e bankave për financim u bënë më të qarta, duke çenuar stabilitetin makro-financiar. Në periudhën ndërmjet 2008-ës dhe 2013-ës, bankat që i raportojnë BIS-it e ulën ekspozimin e tyre ndërkufitar në sektorin financiar të EJL6-ës me 2.8 përqind të PBB-së. Megjithëse modeli tradicional i sektorit financiar, mungesa e instrumenteve më të rrezikshme si dhe ndërmarrja e Iniciativës së Vjenës, e cila kishte për qëllim, *inter alia* të parandalonte tërheqjet e mëdha kapitale nga Evropa Lindore dhe të siguronte kapital të mjaftueshëm të degëve të bankave në Evropën Lindore, i ndihmoi sistemet financiare në rajon ta përballonin krizën globale relativisht mirë.

Tendencat pas krizës flasin për një ndryshim të strukturave financiare në bankat e EJL6-ës drejt mobilizimit të depozitave të brendshme. Depozitat e brendshme u rritën me mesatarisht 9 përqind në periudhën nga viti 2008 deri në fund të vitit 2013 (Tabela IV.1). Ky ndryshim reflektohet dhe në raportin mesatar ndërmjet huave dhe depozitave, i cili vazhdon me lëvizjen e ulët të moderuar, tani në nivelin 98 përqind. Megjithatë, përderisa bankat e huaja zotërojnë ende një mesatare prej 87 përqind të aseteve të sektorit bankar, sistemet financiare të EJL6-ës mbeten ende të varura shumë tek financimi i huaj dhe të ekspozuara ndaj rreziqeve të moslëvrimit nga bankat mëmë. (në përjashtim të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë).

Tabela IV.1: Zhvillimet në sektorin bankar, krahasim në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013

	Shqipëria		Bosnja dhe Hercegovina		Kosova		Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë		Mali i Zi		Serbia	
	2008	2013	2008	2013	2008	2013	2008	2013	2008	2013	2008	2013
Numri i bankave	16	16	30	27	8	9	18	16	11	11	34	30
Pronësi e huaj	93	93	95	82	90	90	84	75	87	90	75	69
Pronësi shtetërore	0	0	1	2	0	0	1	4	0	0	16	17

Aktivitet e sektorit bankar (% e totalit të aktiveve)	95	94	81	87	80	72	89	88	97	97	90	92
Depozitat/PBB-ja	57	70	41	52	34	42	43	55	51	51	33	43
Kreditimi/PBB-ja	35	39	55	52	32	36	42	49	87	54	40	47
Përqëndrimi i aktiveve në 3 banka (%)	55	57	53	45	82	67	73	68	64	51	33	36

Burimet: Autoritetet kombëtare dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore, FinStat

Sfida të tjera ndaj stabilitetit financiar rrjedhin nga përkeqësimi i cilësisë së aktiveve dhe stoku i madh i huadhënies në monedhë të huaj. Huatë e këqija janë rritur në mbi trefish, nga mesatarja prej 5 përqind në periudhën përpara krizës në 16.7 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014. Në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, huadhënia në monedhë të huaj në mes të vitit 2014¹⁹ llogaritej në nga 50 deri në 70 përqind.

Ka disa zhvillime të jashtme që kanë po ashtu ndikim mbi sistemet financiare të EJL6-ës:

- **Arkitektura financiare e BE-së.** Analiza e cilësisë së aktiveve, e botuar kohët e fundit nga ECB-ja, dhe testet e stresit, të cilat shërbejnë si pikë hyrje për në Mekanizmin e Vetëm Mbikëqyrës për bankat sistematikisht të rëndësishme në Eurozonë, kanë krijuar trysni për disa nga bankat mëmë nga Greqia dhe Sllovenia për të tkurrur bilancet e tyre, ose për të ulur kapitalin e mbajtur në degë.²⁰
- **Politikat për uljen e ekspozimit ndërkufitar.** Për më tepër, disa banka mëmë nga Greqia, Austria dhe Sllovenia janë përballur me presione rregullatore nga Komisioni Evropian për të ulur praninë e tyre, ose mundësisht për t'u tërhequr nga EJL6-a²¹. Në të njëjtën kohë, rregullatorët e vendeve pritëse i kanë inkurajuar grupet e bankave mëmë të vendosin kufij më të shtrënguar për financimin e linjave të kreditimit të degëve të tyre në EJL6.²²
- **Reformat globale rregullatore.** Bazel III-i prezanton kuadre të reja rregullatore për kapitalin dhe likuiditetin, si dhe tarifa shtesë kapitale për institucionet globale financiare sistematikisht të rëndësishme që prekin rajonin e EJL6-ës, nëse zbatimi "ngarkohet" nga vendet pritëse.

Forcimi i një procesi të rregullt të uljes së lëvrimit si dhe ribalancimi i modeleve ekzistuese të

¹⁹ Duhet të theksohet se Bosnja dhe Hercegovina ka një bord për trajtimin e monedhës.

²⁰ Shih Bankën Qëndrore Evropiane. 2014. *Raport i Agreguar për Vlerësimin Gjithëpërfshirës*. Frankfurt.

²¹ Kohët e fundit NLB-ja sllovene arriti një plan rikapitalizimi dhe ristrukturimi me Komisionin Evropian (KE), i cili përfshin shkurtimin e portofolit të tij, dhe rritjen e rrezikut për investimin në rajon. Edhe autoritetet greke i kanë udhëzuar bankat e tyre të tërhiqen gradualisht nga rajoni. Hypo Bank u shtetëzua në Austri në vitin 2009 dhe pritet të shitet sic parashikohet nga plani i rikostrukturimit i KE-së.

²² Për shembull, Banka Qëndrore Australiane (OeNB) ka prezantuar në fillim të 2012-ës një sërë masash kapitale, të likuiditetit dhe zgjidhje për të forcuar qëndrueshmërinë e modelit të biznesit të bankave austriake dhe të degëve të tyre.

financimit janë shumë të rëndësishme për zhvillim të mëtejshëm të sektorit financiar dhe rritjen ekonomike në rajon. Masat mund të përqendrohen tek rikalibrimi i modeleve të biznesit të bankave, promovimin e mobilizimit të kursimeve nëpërmjet politikave makroekonomike dhe zhvillimit të tregjeve rajonale kapitale. Ulja e fitimit të bankave krahasuar me nivelet e periudhës para krizës, si dhe xhepat e cënueshmërive ndërmjet bankave individuale kërkojnë vëmendje të vazhdueshme për zbatimin e regjimeve rimëkëmbëse dhe drejtuese të bankave. Duke u mbështetur tek arritjet e Iniciativës së Vjenës, shtetet e EJL6-ës duhet të punojnë për të forcuar më tej bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse në vendet e tyre për të siguruar vijimësinë e stabilitetit financiar, pasi mbikëqyrësit e bankave kërkojnë më shumë informacion rreth profileve të rrezikut të bankave mëmë dhe grupeve bankare.


Përmbytjet e fundit kanë treguar rëndësinë e shtrirjes së tregjeve të sigurimit për të mbrojtur pronarët e shtëpive dhe bizneset kundër fatkeqësive natyrore. Mesatarisht, në Bosnje dhe Hercegovinë, rreth 2 nga 100 pronarë shtëpie janë të siguruar kundër fatkeqësive natyrore. 18 përqind e personave që punojnë (formalisht ose informalisht) në sektorin bujqësor në EJL6, krahasuar me rreth 9 përqind në shtetet e BE11-ës dhe 4 përqind në shtetet e BE15-ës (Figura 49) janë të siguruar. Me mbi 40 përqind të popullsisë në Shqipëri dhe rreth 20 përqind në Bosnjë Hercegovinë dhe Serbi që punojnë në sektorin e bujqësisë, pronat e një pjese të madhe të popullsisë janë të cënueshme ndaj emergjencave natyrore. Familjet e varfra janë më shumë të prirura të punojnë në bujqësi dhe të jetojnë në zonat rurale, duke i bërë ata posaçërisht vulnerabël (Figura 50). Mesatarisht, në EJL6, afërsisht tre në pesë individë jetojnë në zonat rurale krahasuar me dy në çdo pesë familje në gjendje më të mirë ekonomike. Humbjet dhe dëmet e mëdha në bujqësi të shkaktuara nga përmbytjet e kohëve të fundit janë përlllogaritur në rreth 200 milionë euro vetëm në Bosnje dhe Hercegovinë. Është prekur rreth 17 përqind e tokës së punueshme, dhe një numër i vogël banorësh ruralë pësuan humbjet më të mëdha (me humbje të shpendëve që arrinin deri në 80 përqind në disa fshatra).

Përmirësimet në sistemet e sigurimit dhe mbulimit mund të ndihmonin në lehtësimin e ndikimeve negative të ndryshimeve klimaterike në EJL6, dhe këto përmirësime ka të ngjarë të mbështesin posaçërisht popullsinë e varfër dhe rurale. Megjithatë, pak vetë nga ata që mbështeten tek bujqësia për të nxjerrë jetesën janë të mbuluar me siguracione. Për shembull, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, vetëm 4 përqind e fermerëve të regjistruar i kanë siguruar të mbjellat nga dëmet e shkaktuara nga moti. Në Kosovë, kompanitë e sigurimeve përfaqësonin vetëm 3 përqind të totalit të aktiveve të sistemit financiar në tremujorin e dytë të 2014-ës, ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë ata përfaqësonin vetëm 5 përqind të totalit. Përmbytjet e fundit theksuan rëndësinë e mbulimit me sigurime në Bosnje dhe Hercegovinë, me sondazhe që dëshmonin se në pjesën më të madhe të zonave në vend, njerëzit mbështeteshin më shumë tek kursimet ose kontributet e anëtarëve të familjes sesa tek sigurimet.²³

Figura 49: Përqindja e punësimit në bujqësi, 2012


Figura 50: Përqindja e individëve që jetojnë në zonat rurale

²³Për shembull, në Tuzla dhe Banja Luka vetëm një nga dhjetë ferma dhe biznese mundi të riparonte dëmet me pagesat e siguracionit, ndërsa katër në dhjetë ferma u mbështetën tek kursimet (zonat rurale kishin më pak të ngjarë të mbështeteshin tek kursimet). Në Banja Luka, çereku i personave të prekur i riparuan dëmet duke përdorur fonde nga familja, duke theksuar kështu rëndësinë e remitançave (të brendshme ose ndërkombëtare) për lehtësimin e ndikimit të emergjencave dhe të rolit të tyre si një lloj siguracioni.



Burimi: Treguesit e Bankës Botërore

Shënim: Të dhënat e Shqipërisë nga viti 2010 dhe të dhënat e Holandës (në BE15) nga viti 2011. Sipas Censurit Bujqësor të 2010-ës, vetëm 5 përqind e punësimit bujqësor është formal; për pasojë vlerësimet në shifrat e mësipërme lidhen vetëm me punësimin në bujqësi.



Burimi: Banka Botërore 2014, Temë e Veçantë e RRRë-së: Analiza për promovimin e prosperitetit të përbashkët në Evropën Juglindore.

Shënim: Periudhat e mbuluara për secilin vend janë si më poshtë: Shqipëria (2012), Bosnja dhe Hercegovina (2007), Kosova (2011), Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (2008), Mali i Zi (2011), Serbia (2010), BE11-a (2010)

II. PERSPEKTIVA

Rajoni i EJL-së parashikohet të rritet me 1.3 përqind në vitin 2015, mbështetur nga një kërkesë e huaj gradualisht në rimëkëmbje, veçanërisht nga Evropa, dhe stabilizimi i çmimeve ndërkombëtare të energjisë rreth niveleve aktuale. Sipas skenarit bazë, kërkesa e jashtme do të mbetet shtytja kyçe e rritjes në mbështetje të aktivitetit industrial të EJL6-ës dhe rritjes së eksporteve. Kushtet e favorshme të politikave monetare të Eurozonës kanë të ngjarë të vijojnë ta ndihmojnë EJL6-ën të rrisë eksportet. Për më tepër, çmimet relativisht të ulëta të naftës, të shoqëruara si me përpjekjet e familjarëve dhe të qeverisë për rindërtim pas dëmeve të shkaktuara nga ngjarjet klimaterike të kohëve të fundit mund të mbështesin kërkesën e brendshme dhe të kenë ndikim pozitiv mbi rritjen në rajon. Megjithatë, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, kërkesa e brendshme në EJL6-ës ka të ngjarë të mbetet e ndrydhur pasi besimi i konsumatorëve dhe i biznesit mbeten të dobëta për shkak të pasigurisë së zgjatur politike, papunësisë së lartë kronike, klimës së dobët të biznesit, dhe sistemeve bankare të ngarkuara shumë me hua të këqija. Performanca e tregut të punës në EJL6 ka të ngjarë të përkeqësohet (ose në rastin më të mirë të mbetet në vend) pasi rënia e ritmit të rritjes në vitin 2014 në Serbi dhe në Bosnje dhe Hercegovinë ka të ngjarë të reflektohet tek rezultatet e tregut të punës me ca vonesa. Nga ana tjetër, mund të priten përmirësime të vogla në nivelin e punësimit në një rajon (në EJL6) me rritje më të shpejtë. Përpjekjet për konsolidim fiskal mendohet të vazhdojnë në vitin 2015 në EJL6, me përjashtim të Malit të Zi, ku fillimi i projektit të ndërtimit të një autostrade do të rrisë ndjeshëm deficitin fiskal. Në aspektin e jashtëm, bilancet e llogarive korrente të EJL6-ës ka të ngjarë të stabilizohen rreth niveleve aktuale, pasi rritjet e pritshme në kërkesën e jashtme për eksportet e EJL6-ës kompensohen kryesisht nga rritja e importeve në mbështetje të kërkesës së brendshme.

Tabela 2. Parashikimet për rritjen reale të PBB-së

	2013	2014e	2015f
ALB	1.4	2.1	3.0
BIH	2.5	0.4	1.0
KSV	3.4	2.5	3.0
MKD	2.7	3.3	3.5
MNE	3.3	1.5	3.4
SRB	2.6	-2.0	-0.5
SEE6	2.5	0.2	1.3
Memo item: Eurozone	-0.4	0.8	1.1

Burimi: Vlerësimet dhe parashikimet e Bankës Botërore.

Shënim: EJL6-a si mesatare e ponderuar

Parashikimi i PBB-së së EJL6-ës në vitin 2015 prej 1.3 përqind është shumë më i ulët se parashikimi i Grupit të Bankës Botërore (WBG) në maj të vitit 2014. Parashikimi i mëparshëm ishte 2.7 përqind rritje në vitin 2015, dy herë më i lartë sesa rritja aktuale prej 1.3 përqind. Për më shumë, ky ritëm është goxha më i

ulët sesa parashikimet e Grupit të Bankës Botërore për ekonomi të tjera evropiane në tranzicion, ku rritja në vitin 2015 parashikohet të jetë 2.8 përqind.²⁴ Rritja në EJL6 ka të ngjarë të pengohet nga rimëkëmbja e dobët në Bosnje dhe Hercegovinë dhe, mesa duket, nga një tjetër recesion në Serbi. Serbia, ekonomia më e madhe e EJL6-ës, po shkon drejt një konsolidimi të konsiderueshëm fiskal dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve kryesore shtetërore për ta sjellë borxhin publik në nivel të qëndrueshëm, gjë e cila ka të ngjarë të shërbejë si shtysë për aktivitetin ekonomik në vitin 2015. Shqipëria, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali i Zi priten të rriten me mbi 3 përqind në vitin 2015, dhe me rritjen ekonomike që arrin deri në 3.8 përqind në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Rritja ekonomike në këto katër shtete pritet të përshpejtohet në kurriz të kërkesës së jashtme më të fortë se aktualisht, përmirësimeve modeste në tregun e punës (uljet në papunësi) dhe momentit të përshtatshëm në ndërtim, shërbime dhe turizëm.

Rritja potenciale e produktit mbetet e kufizuar nga sfidat strukturore. Funkcionimi i tregjeve të punës në të gjithë rajonin vuan nga anemia, me nivele të vazhdueshme të larta të papunësisë, nivele të ulëta të pjesëmarrjes së krahut të punës dhe krijimin e ngadaltë të vendeve të punës. Megjithëse është bërë ca përparim për lehtësimin e barrave të klimës së investimeve, ka ende vend për përmirësim. Sektori publik është i madh dhe jo eficient në shumë prej shteteve të rajonit. Në të gjitha shtetet, investimet për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe/ose përmirësimin e stokut kapital do të ndihmonin në zëvendësimin e infrastrukturës aktuale të vjetëruar dhe në nxitjen e potencialit ekonomik, me kusht që këto investime të kenë kthime ekonomike pozitive dhe të mos kërcënojnë qëndrueshmërinë e borxhit publik. Përmirësimi i lidhjes së rajonit të EJL6-ës nëpërmjet lidhjeve fizike dhe institucionale ndërmjet vendeve të rajonit, me BE-në, dhe me pjesën tjetër të botës, do t'i ndihmojë firmat konkurruese të EJL6-ës të mbërrijnë në tregje të reja dhe do të bëjë të mundur thithjen e investitorëve të huaj në rajon. Përparimi në procesin e pranimit në BE përfaqëson një mundësi për EJL6-ën për të ndjekur axhendën e BE-së, e cila ka po ashtu ndikim pozitiv mbi rritjen potenciale. (Kutia VI)

Për pasojë, rritja ekonomike në kuadrin afatmesëm dhe afatgjatë në EJL6 mund të mbështetet nëpërmjet politikave ekonomike të shëndetshme dhe me përparësi të përcaktuara mirë për të trajtuar këto pengesa strukturore. Në aspektin fiskal, nevojiten përpjekje për reformë të qëndrueshme për të trajtuar ngurtësinë strukturore në buxhetet e EJL6-ës. Përparësitë përfshijnë: ndryshime në përbërjen e shpenzimeve publike drejt investimeve produktive dhe larg pagave; shpenzimet publike të synuara dhe parësore; shlyerjen e pagesave të prapambetura; përmirësimin në mbledhjen e të ardhurave; zgjerimin e bazës së tatueshme ndërsa ulet hendeku i tatimit të punës, ndërmjet të tjerash. Lidhur me aspektin e politikave monetare, me inflacionin rajonal në nivele të ulëta dhe me hendeqet në produkte ende të pranishme thuhet në të gjitha ekonomitë e EJL6-ës, ekzistojnë disa arsye për lehtësimin afatshkurtër të kushteve monetare, veçanërisht në ato vende ku deficitin ka filluar të ulet. Megjithatë, në ekonomitë me kurs valutë fleksibël duket të tregohet kujdes për t'u siguruar se ato nuk do të vihen në presion. Hapësira për lehtësim të mëtejshëm të politikave monetare është e kufizuar edhe më, pasi nivelet e politikave janë ende të ulëta sipas standardeve historike dhe borxhi i marrë në monedhë të huaj është

²⁴ Banka Botërore. 2015. *Perspektivat e Ekonomisë Globale*. (janar 2015)

ende i lartë. Lidhur me politikat e sektorit financiar, trajtimi i huave të shumta të këqija do të jetë shumë i rëndësishëm për të trajtuar përfundimisht çështjen e rritjes së kreditimit, mbështetjen e sipërmarrjes dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Përveç sfidave strukturore, ka disa rreziqe të jashtme negative dhe specifike të lidhura me vendet përkatëse të rajonit për parashikimin afatshkurtër të shteteve të EJL6-ës. Këto rreziqe përfshijnë:

- (i) **Efektet e programeve të planifikuara fiskale dhe të privatizimit në vijim e sipër mund të çënojnë negativisht mbështetjen e reformave nga publiku.** Ekonomitë e EJL6-ës janë të ndjeshme ndaj mungesës së stabilitetit politik, që mund të vijë si rezultat i konsolidimeve të planifikuara fiskale dhe/ose privatizimeve dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve shtetërore.
- (ii) **Rreziku i deflacionit në EJL6 vijon të jetë ekzistues.** Rimëkëmbja e dobët ekonomike brenda vendit, inflacioni i ulët tek partnerët tregtarë, të tillë si BE-ja, uljet e mëtejshme të çmimit të naftës, si dhe pritshmëritë inflacioniste mund të vijojnë të ushtrojnë presione negative mbi rritjen. Rritja e ndrydhur e kërkesës agregate e shtypur nga prania e konsolidimit të politikave fiskale do të mbetet një faktor i fortë deflacioni. Deflacioni do ta vështirësojë pagimin e borxhit të madh nga sektori publik dhe nga sektori privat. Deflacioni do të përkeqësojë rimëkëmbjen e ngadaltë të investimeve dhe do të zgjasë konsumin e ulët. Për më tepër, deflacioni ka të ngjarë të rrisë huatë e këqija, të cilat, nga ana e tyre, do të përkeqësojnë rrethën vicioz të uljes së kreditimit, kërkesës së pamjaftueshme dhe rimëkëmbjes së brendshme.
- (iii) **Rritja ekonomike globale më e ulët se pritshmëria (veçanërisht në BE) mund të kufizojë si kërkesën e jashtme për eksporte në EJL6, dhe financimin e jashtëm të disponueshëm për këto shtete.** Parashikimet pozitive të rritjes për vitin 2015 do të kërkojnë vazhdim të rritjes së shtyrë nga eksporti në tregun më të madh të EJL6-ës, në BE. Rimëkëmbja më e ngadaltë sesa parashikohet mund të ulë eksportet drejt BE-së dhe investimet nga BE-ja (veçanërisht nga sektori i prodhimit). Duke u mbështetur fort në sektorin bankar evropian për nevojat për financim, rimëkëmbja e ngadaltë mund të ulë edhe disponueshmërinë e financimit. Ulja e borxhit mbetet ende rrezik pasi disa banka mëmë planifikojnë të ulin më shumë praninë e tyre në EJL6 për shkak të presionit të vazhdueshëm të tregut dhe të atij rregullator. Analiza e cilësisë së aseteve të Bankës Qëndrore Evropiane, e botuar së fundmi, përmban implikime të rëndësishme për EJL6-në pasi bankat mëmë në Greqi dhe Slloveni nuk i përmbushën standardet e analizës së cilësisë së aseteve dhe të testeve të stresit të kryera nga Banka Qëndrore Evropiane (ECB)²⁵. Më tej, disa banka mëmë (si banka sllovaqe NLB, banka greke dhe disa banka austriake) përballen me presione rregullatore për shkurtime, ose dhe mbase dhe tërheqje nga EJL6-a.
- (iv) **Edhe rreziqet politike i zbehin mundësitë e EJL6-ës për rritje.** Për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me BE-në dhe me Rusinë, ekonomitë e EJL6-ës janë të ndjeshme ndaj efekteve të intensifikimit të tensioneve potenciale gjeopolitike që rrjedhin nga kriza e Rusi-Ukrainë. Në

²⁵ Shih Bankën Qëndrore Evropiane. 2014. *Aggregate Report on the Comprehensive Assessment*. Frankfurt.

- Kutinë V flitet për krizën e Ukrainës mbi ekonomitë rajonale. Ka efekte potenciale, të cilat, nëse realizohen, do të çojnë në rritje më të ulët dhe pasoja të tjera negative për EJL6-ën.
- (v) **Kushtet e këqija të motit kanë dëshmuar se kanë efekte të mëdha negative mbi perspektivën e rritjes ekonomike në rajon.** Rajoni ka provuar se është i cënueshëm ndaj ngjarjeve tronditëse të motit, një problem që ka të ngjarë të përkeqësohet në kuadrin afatmesëm deri në afatgjatë, me ndryshimet klimaterike që prekin rritjen potenciale dhe financat publike. Thatësisht kanë shumë ndikim mbi kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga rajoni, moti i keq ka ndikim mbi eksportet e turizmit, përmbytjet kanë ndikim mbi bujqësinë, ndërsa dimrat e ashpër ulin prodhimin dhe konsumin. Ky i fundit mund të ketë po ashtu ndikim mbi financat e sektorit publik dhe deficitin e llogarive korrente teksa shtetet përpiqen të rindërtojnë pas dëmeve të shkaktuara dhe pas tkurrjeve të të ardhurave nga qeveria për shkak të uljes së aktivitetit ekonomik. Megjithatë EJL6-a nuk ka kaluar valë të nxehta si zona të tjera të Evropës në vitin 2014 dhe 2007, nëse ndodhin, ato mund të ulin produktivitetin dhe të ushtrojnë presion mbi sistemet shëndetësore të rajonit. Familjet e varfra mund të jenë më të ndjeshme ndaj shumë dukurive shokuese të motit sesa familjet e tjera (p.sh. situata shokuese shëndetësore, ose situata që kanë ndikim mbi bujqësinë). Duhet të merren parasysh si masat lehtësuese dhe ato të përshtatjes (p.sh. duke ndërtuar mbrojtje nga përmbytjet ose infrastrukturë që i reziston motit) për të ulur efektin e këtyre situatave mbi rritjen ekonomike dhe varfërinë, si dhe mbi financat publike të qeverisë.

Kutia V: Efektet potenciale të krizës së Ukrainës mbi ekonomitë e EJL6-ës

Aneksimi i Krimesë nga Ukraina në shkurt të vitit 2014 shkaktoi krizë politike dhe ekonomike në Ukrainë. PBB-ja e saj pritej të tkurrej me 8 përqind dhe deficiti i konsoliduar fiskal²⁶ parashikohej në 10.1 përqind të PBB-së në vitin 2014. Ngjarjet shkaktuan reagim të fortë në të gjithë botën. SHBA-ja dhe BE-ja vunë sanksione, të cilat, të shoqëruara me pasigurinë e përgjithshme rreth zhvillimeve gjeopolitike, çmimet e ulëta të naftës dhe dobësive të vazhdueshme strukturore, e çuan ekonominë ruse në stanjacion, me rritjen e parashikuar në të njëjtin nivel prej 0.4 përqind në periudhën afatmesme. Ekonomitë e EJL6-ës kanë qenë të ndjeshme ndaj efekteve të krizës për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me BE-në dhe Rusinë.

Konsumi i gazit natyror është domethënës në dy prej vendet e EJL6-ës, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, të cilat importojnë pjesën më të madhe të gazit natyror nga Rusia përmes Ukrainës. Mundësia e ndërprerjes të importeve të gazit përbën kërcënim të madh për sigurinë energjitike të këtyre vendeve. Prodhimi i brendshëm i gazit natyror dhe kapacitetet e ruajtjes janë të kufizuara në Bosnje dhe Hercegovinë. Për pasojë, kjo ndërprerje ka të ngjarë të ketë ndikim më të madh në ekonominë e saj sesa në Serbi, ku prodhimi i brendshëm dhe stoku aktual mund të mbulojë thuajse gjysmën e konsumit vjetor me gaz natyror. Në një raport të Komisionit Evropian thuhet se në rastin e ndërprerjes së importeve të gazit nga Rusia, disponueshmëria e gazit në Bosnje dhe Hercegovinë mund të ulet deri në 80-100 përqind jo më vonë se brenda pak javësh. Masat lidhur me kërkesën mund të ulin efektet; megjithatë, mungesa e një mekanizmi të plotë tregu për shpërndarjen e gazit dhe vështirësitë teknike në rrjetin e shpërndarjes kanë

²⁶ Përfshin Naftogaz-in.

të ngjarë ta bëjnë të vështirë zbatimin e tyre.

Efektet e sanksioneve të vendosura mbi Rusinë mund të depërtojnë dhe në shtetet e EJL6-ës. Tregtia e aluminit të Malit të Zi me Grupin Rus CEAC u pezullua në vitin 2013. Në Malin e Zi numërohen nga 5,000 deri në 7,000 rusë me banim të përhershëm. Nënshetetasit rusë zotëronin 32 përqind të kompanive të huaja në Malin e Zi në vitin 2012. Prurjet e fondeve nga Mali i Zi në Rusi mund të preken drejtpërdrejt nga sanksionet, ose nëpërmjet efekteve të tyre mbi rritjen ekonomike të Rusisë. Vijimi i ngadalësimit në Rusi ka të ngjarë të ulë dhe eksportet në turizmin e Malit të Zi. Gjatë dhjetë muajve të parë të vitit 2014, rreth 21 përqind e të gjitha prurjeve të turistëve dhe 27 përqind e turistëve me qëndrim gjatë natës ishin rusë.

Rritja e EJL6-ës është e ndjeshme dhe ndaj disa efekteve të dorës së dytë. Për shembull, ekonomitë e Shqipërisë, Kosovës, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi nuk varen fare ose pak nga konsumimi i gazit natyror. Megjithatë, ndërprerja e furnizimit me gaz natyror ka të ngjarë të rrisë kërkesën e rajonit për energji elektrike, e cila do të kishte ndikime mbi çmimet e brendshme të energjisë elektrike dhe të artikujve ushqimorë. Më tej, ekonomitë e EJL6-ës varen shumë tek tregjet e BE-së, pasi BE-ja është destinacioni kryesor për eksportet e EJL6-ës në mallra dhe shërbime. BE-ja importon 53 përqind të konsumit të saj energjistik dhe 66 përqind të gazit të saj natyror. Rreth çereku i konsumit të gazit në BE importohet nga Rusia dhe gjysma e këtyre importeve bëhen nëpërmjet Ukrainës. Ndërprerja e eksporteve të gazit rus në BE do të kishte veçanërisht ndikim mbi Evropën Jugore dhe në Baltik, dhe më pas në EJL6 nëpërmjet uljes së kërkesës së jashtme.

Në përgjithësi, zgjatja e krizës në Ukrainë parashikohet të ulë rritjen e EJL6-ës në vitin 2015 nga 1.9 përqind në 1.8 përqind.


Shënim: Komisioni Evropian ka botuar rezultatet e testit të stresit të kryer për të testuar pasojat e ndërprerjes së importeve në gaz natyror nga Rusia mbi sigurinë energjitike evropiane në tetor të vitit 2014. Testi përfshin shtetet e BE-së, EJL6-ës, Ukrainës, Moldavisë, dhe Gjeorgjisë. Raporti mund të gjendet në http://ec.europa.eu/energy/stress_tests_en.htm.

Nga ana tjetër, vijimi i çmimeve të ulëta të naftës mund të mbështesë një rritje më të madhe ekonomike në EJL6. Të gjitha shtetet në rajon importojnë sasi të konsiderueshme naftë, me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë që importon lëndë djegëse me vlerë deri në 10 përqind të PBB-së. Importet neto të lëndës së djegëshme ishin po ashtu të larta, në 5 deri në 6 përqind të PBB-së mesatarisht në periudhën 2012-13. Për pasojë, një rënie e mëtejshme e çmimit të naftës do të kishte ndikime domethënëse mbi bilancin e llogarive korrente të të gjitha shteteve, me përjashtim të Shqipërisë (e cila ka po ashtu eksporte të mëdha naftë, dhe për pasojë, mund të vuajë nga çmimet aktualisht të ulëta). Simulimet tregojnë se rënia e çmimit të naftës në rreth 40 përqind gjatë të gjithë vitit 2015 krahasuar me mesataren e çmimit të 2013-ës mund të çojë në uljen mesatare në deficitin të llogarive korrente në EJL6 me rreth 2 pikë përqindje krahasuar me parashikimet aktuale. Ulja e qëndrueshme e çmimit të naftës mund të ketë po ashtu ndikim pozitiv mbi aktivitetin ekonomik për shkak të uljes së kostove për firmat dhe konsumatorët dhe nxitjes së rritjes ekonomike.

Ulja e çmimeve të naftës nuk vjen pa pasojë negative. Me TVSH-në si burim i rëndësishëm të ardhurash për portofolin publik, ulja e çmimit të naftës përkthehet në të ardhura më të ulëta tatimore. Mund të duhet të merren masa për të ngritur nivelin e mbledhjes së tatimeve, për shembull, duke rritur taksën mbi akcizën. Qeveritë mund të shqyrtojnë po ashtu marrjen e masave alternative të politikave tatimore (p.sh. akcizat e karburantit, taksat e duhanit, taksën e karbonit) për të financuar uljet e tatimeve të tjera,

dukshëm ato mbi punën, për të inkurajuar rritjen e punësimit. Së fundmi, nëse çmimet e ulëta të naftës përkthehen në pritshmëri të ulëta të inflacionit, inflacioni që nuk ka të bëjë me karburantin mund të ulet më tej, duke u shoqëruar me rreziqet përkatëse.

Kutia VI: Progresi i EJL6-ës në rrugën drejt anëtarësimit



Katër nga shtetet e EJL6-ës janë aktualisht shtete kandidate për pranim në BE, dhe vetëm njëri prej tyre i ka hapur negociatat për anëtarësim. **Mali i Zi** e mori statusin e shtetit kandidat për në BE në tetor të vitit 2010, ndërsa negociatat për pranim u hapën në qershor të vitit 2012. Procesi i skanimit të BE-së në Malin e Zi përfundoi në maj të vitit 2014. Në procesin e negociatave deri tani, janë mbyllur përkohësisht dy kapituj dhe janë hapur 16 kapituj. **Serbia** u bë shtet kandidat në mars të vitit 2012. Këshilli Evropian vendosi të hapte negociatat për pranim me Serbinë në qershor të vitit 2013 dhe organizoi Konferencën e Parë Ndërqeveritare me Serbinë në janar të vitit 2014. Në fund të 2014-ës, ishin kaluar 26 nga 35 kapitujt, por asnjëri nga kapitujt nuk është hapur për negociatat për shkak të mungesës së progresit lidhur me “Marrëveshjen e Brukselit” ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë** e ka marrë statusin e shtetit kandidat që prej dhjetorit të 2005-ës. Megjithëse Komisioni ka rekomanduar në shumë raste hapjen e negociatave për pranim që prej tetorit të 2009-ës, rekomandimi nuk është miratuar ende nga Këshilli Evropian dhe hapja e negociatave është shtyrë. **Shqipëria** e mori statusin e shtetit kandidat në qershor të 2014-ës.

Dy nga shtetet e EJL6-ës kanë statusin e kandidatit potencial në BE. Për **Bosnjën dhe Hercegovinën**, BE-ja mbetet e vendosur në mesazhin e saj për autoritetet: “vendi duhet të reformohet.” Pas angazhimit për një axhendë reformash, BE-ja mund të hapë po ashtu MSA-në me Bosnje dhe Hercegovinën në vitin 2015. Në korrik të 2014-ës, negociatorët kryesorë të BE-së dhe të **Kosovës** filluan Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, e cila pritet të nënshkruhet në vitin 2015.

Burimi: Komisioni Evropian, në adresën ec.europa.eu

MOMENTI I RËNDËSISHËM I. NDIKIMI EKONOMIK I NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE NË EJL6 DHE MËSIMET E NXJERRA NGA STUDIMI I RITJES SË GJELBËRT NË ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

Klima po ndryshon, dhe jo për më mirë në pjesën më të madhe të botës. Raporti i Pestë i Vlerësimit i IPCC-së i vitit të shkuar (AR5) vërente se “ndikimi njerëzor në sistemin klimaterik është i qartë, dhe çlirimet antropogjene të kohëve të fundit të gazrave serë janë më të lartat në histori. Ndryshimet klimaterike të kohëve të fundit kanë pasur ndikime të mëdha mbi sistemet njerëzore dhe natyrore”, ndërsa “çlirimet e vazhdueshme të gazrave serë në atmosferë do të shkaktojnë nxehje të mëtejshme dhe ndryshime me shtrirje të gjatë në të gjithë komponentët e sistemit klimaterik, duke rritur gjasat për ndikime të rënda, depërtuese dhe të patjetërsueshme për njerëzit dhe për ekosistemet. Kufizimi i ndryshimeve klimaterike kërkon ulje domethënëse dhe të qëndrueshme për çlirimet e gazit sere, të cilat, sëbashku me përshtatjen, mund të kufizojnë rreziqet e ndryshimeve klimaterike.”²⁷

Ndryshimi i klimës pritet të shkaktojë dëme mbi ekonominë gjatë viteve në vijim, megjithëse Evropa do të vuajë më pak se pjesa më e madhe e rajoneve të tjera. Këto dëme mund të shkaktohen nga ngjarje moti ekstrem: përmbytje dhe stuhi, valë të nxehta dhe zjarre të egra, dhe rritja e nivelit të detit; dhe aktivitete të tjera atë lidhura me to, të tilla si përhapja e sëmundjeve. Dëmi mund të vijë nga uljet e produktivitetit të shtyra, për shembull nga mungesa në rritje e ujit. Dëmi mund t’u drejtohet drejtpërdrejt njerëzve, shtëpive dhe pronave të tyre, ose mund të jenë të natyrës së dëmeve të infrastrukturës ose të kapitalit. Vlerësimet e kostove globale në raport me PBB-në botërore në vitin 2050 lidhur me ndryshimin e klimës, nuk e kalojnë përgjithësisht nivelin 2 përqind. Evropa është rajoni që do të vuajë më pak nga ndryshimet klimaterike sesa pjesa tjetër e botës. Megjithatë, edhe Evropa nuk do të shpëtojë nga ndikimet e mëdha negative, disa prej të cilave po marrin trajtë.²⁸ Analiza e përditësuar e AR5-ës thotë që frekuenca e valëve të nxehta është rritur në pjesët më të mëdha të Evropës që prej vitit 1950 ashtu siç edhe frekuenca e reshjeve të dendura.²⁹

Ekstremet klimaterike në rajonin e EJL6-ës po shkaktojnë aktualisht dhe do të vazhdojnë të shkaktojnë edhe në të ardhmen rreziqe të mëdha ndaj sistemeve bujqësore, energjitikës dhe shëndetit të njerëzve. EJL6-a është posaçërisht e ekspozuar ndaj efekteve të ngjarjeve ekstreme, përfshirë ngrohjen, thatësitrat dhe përmbytjet. Ekstremet e të nxehtit do të bëhen të zakonshme për rajonin e EJL6-ës, ndërsa rreziku i thatësirave është i lartë. Në të njëjtën kohë, parashikimet sugjerojnë rritje të prurjeve të trupave ujore,

²⁷ IPCC, “Deklaratë kryesore nga Përmbledhja e Politikëbërësve”, 5 nëntor, 2014, Raporti i Sintezës së Ndryshimeve Klimaterike të 2014-ës.

²⁸ Së pari, analiza e AR5-ës jep një vlerësim të ndryshimeve ekstreme dhe të ngjarjeve klimaterike që prej vitit 1950, më pas të kontributit të njerëzve për ndryshimet e vëna re, dhe gjasat për ndryshime të mëtejshme përgjatë shekullit të 21^{të}.

²⁹ IPCC, 2013: Përmbledhje për politikëbërësit. Për: ndryshimet klimaterike 2013: Baza shkencore fizike. Kontributi i Grupit të 1-rë të Punës në Raportin e Pestë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimaterike [Stocker, T.F., D. Qin, G.-K. Plattner, M. Tignor, S.K. Allen, J. Boschung, A. Nauels, Y. Xia, V. Bex dhe P.M. Midgley (eds.)]. Cambridge University Press, Cambridge, United Kingdom dhe New York, NY, USA.

veçanërisht në pranverë dhe në dimër, për shkak të shkrires së më shumë bore gjatë pranverës dhe rritjes së sasive të reshjeve gjatë muajve të dimrit (megjithatë, parashikimet për nivelin e reshjeve janë shumë të pasigurta). Përderisa pjesa më e madhe e bimëve ujiten nga reshjet, ato janë shumë të ndjeshme ndaj ndryshimit të parashikuar klimaterik. Kullotat dhe ekosistemet prej bari për kullotjen e gjësë së gjallë mund të preken nga thatësira dhe nxehtësia e gjatë dhe, për pasojë mund të ulen në pjesë të mëdha të Ballkanit Perëndimor. Më tej, sistemet e energjisë janë të ndjeshme ndaj ngjarjeve ekstreme dhe temperaturave të ujit të liqeneve. Ndryshimi i sezonalitetit të prurjeve të lumenjve mund të cenojë më tej prodhimin e hidrocentraleve, ndërkohë që pjesa më e madhe e shteteve të EJL6-ës varen nga burimet hidroelektrike për të paktën 1/5 e prodhimit të tyre energjistik. Së fundmi, ngjarjet ekstreme të motit dhe shfaqja e vektorëve të rinj të sëmundjeve paraqesin rreziqe për shëndetin e njerëzve. Sezonaliteti i vdekshmërisë së lidhur me temperaturën mund të kalojë nga dimri tek vera në të gjithë Evropën kontinentale. Rreziqe të tjera shëndetësore mund të vijnë si rezultat i ndryshimeve klimaterike që çojnë në kushte të favorshme për insektet që transmetojnë sëmundje, të tilla si ethet tropikale dhe ethet Chikungunya.³⁰


Një program i kohëve të fundit i punës analitike në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ilustron mënyrën sesi mund të përcaktohet ndikimi ekonomik i ndryshimeve klimaterike dhe jep përgjigjen më të mirë të përshtatjes ndaj këtij ndryshimi, brenda një vlerësimi të gjerë të rritjes së gjelbër të integruar. Ndryshimet e planifikuara klimaterike do të kenë ndikim mbi ekonominë e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, kryesisht për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë mbi bujqësinë dhe ndikimeve pasuese në sektorë të tjerë të ekonomisë, dhe, në një shkallë më të vogël, për shkak të humbjeve të shkaktuara nga ngjarjet e motit ekstrem. Ndikimi i ndryshimit klimaterik mbi furnizimin me ujë të Maqedonisë vlerësohet të jetë i madh dhe i gjerësisht i pranishëm, dhe do të ndodhë duke filluar që nga viti 2020 në pjesët më të mëdha të vendit, por me ulje më të mëdha në volumin mesatar të ujit deri në vitin 2050 tek lumenjt, teksa temperaturat rriten dhe reshjet e shiut ulen. Ndryshimet në sasitë e reshjeve dhe modelet e përkohshme dhe hapsinore do të kenë tendencë të ulin sasinë e ujit në dispozicion të sektorëve të konsumit, bujqësisë, hidrocentraleve, ftohjeve termoelektrike, dhe kërkesës industriale dhe bashkiake, veçanërisht në kohën e pikut të kërkesës. Rritja e mungesës së ujit do të cenojë produktivitetin e të mbjellave dhe të ardhurat nga bujqësia. Ndërsa vendi bëhet më i thatë dhe më i ngrohtë, rreziku i përmytjeve do të ulet, por do të rritet rreziku i zjarreve të egra.

Analiza e sektorit të ujit kishte si qëllim të vlerësonte ndikimin e ndryshimeve klimaterike për përdorimet konkurruese të ujit, veçanërisht nga bujqësia dhe sektori i energjisë. Janë përdorur disa modele, duke filluar nga Modelet Globale të Qarkullimit, planifikimi i ujit, humbjet e ujit, dhe modeli i prodhimit bujqësor. Konkurrenca për ujin ndërmjet bujqësisë (veçanërisht kur të ngrohet klima dhe kur të jetë më thatësirë), sektorit të prodhimit të energjisë elektrike (për hidrocentralet një element kritik për një sistem elektrik me emetime më të ulëta, dhe për ftohjen termale), dhe përdorimit industrial dhe bashkiak do të kërkojë bërjen e përzgjedhjeve të vështira për politikëbërësit e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë deri në vitin 2020, në rast se nuk mbështetet eficaenca si në anën e kërkesës dhe të ofertës.

³⁰ Banka Botërore (2014), Turn Down the Heat: Confronting the New Climate Normal.

Rritja e nivelit të mungesës së ujit mund të trajtohet, pikë së pari, duke ulur ineficencat nëpërmjet çmimeve dhe rregullimit të ujit nëntokësor dhe nëpërmjet rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës ekzistuese. Mungesa sezonale në rritje mund të menaxhohet nëpërmjet investimit më shumë në fushën e ruajtjes/depozitimit të ujit (për ujitje dhe për hidrocentrale), ndërsa mangësitë e përgjithshme në dekadat në vijim mund të trajtohen nëpërmjet inkurajimit të ruajtjes së ujit. (Shih Figurën I.1 për mënyrën sesi veprimet e gjelbra mund të ndihmojnë në uljen e hendeqeve kërkesë-ofertë për ujin për arsye ujitje). Në të njëjtën kohë, zhvillimi i bujqësisë drejt fermave më të mëdha, më konkurruese, dhe të orientuara drejt eksportit do të çojnë në rritje të përgjithshme në sektor, ndërsa përmirësohet rezistenca ndaj ndryshimeve klimaterike. Investimet në infrastrukturë ujitje dhe kullimi në nivel baseni (siç u vu re më sipër) do të jenë shumë të rëndësishëm për të ndihmuar plotësimin e kërkesës për furnizimin me ujë. Edhe investimet ambicioze përshtatëse në bujqësi mendohet të sjellin përfitime deri në vitin 2050 që i tejkalojnë katër herë kostot. Në të njëjtën kohë, konsolidimi i tokës, kalimi tek të mbjellat me vlerë të lartë, tek fushatat për edukimin e fermerëve, sëbashku me përmirësime të tjera të efikasitetit, do të çojnë në rritjen e të ardhurave bujqësore dhe do të kompensojnë mungesat në ujë. (Shih Figurën I.2 për mënyrën sesi përpjekjet për përshtatjen në skenarët e gjelbër çojnë në më shumë të ardhura dhe në rritje të efikasitetit të ujitjes).


Figura SI.1. Kërkesa e plotësuar dhe e paplotësuar për ujë për ujitje, sipas rajoneve të planifikimit, në MCM, 2050



Shënim: Skenari super i gjelbër është një plan ambicioz përshtatjeje, skenari i gjelbër është përshtatje modeste, BAU-ja është skenari biznes si zakonisht. MCM-ja është shkurtimi i milionë metrash kub. Hija e zbardhur përfaqëson kërkesën e paplotësuar për ujitje, ndërsa pjesa me ngjyrë të errët kërkesën e plotësuar.

Burimi: Banka Botërore (2014), Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Vlerësimi i vendit me rritje të gjelbër.

Figura SI.2. Ndikimi i skenarëve të përshtatjes mbi bujqësinë, 2011-50



Shënime: Kostot janë vlerat aktuale nga 2011-a deri në 2050-ën të rrjedhës të shpenzimeve të kërkuara shtesë (investime dhe O&M) krahasuar me BAU-n. Të ardhurat janë vlera aktuale në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2050 të prurjes së të ardhurave graduale në sektor. Boshllëku i kërkesës dhe ofertës së ujit është diferenca ndërmjet kërkesës dhe ofertës së ujit (deficiti), e paraqitur si përqindje e kërkesës.

Burimi: Banka Botërore (2014), Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Vlerësimi i vendit me rritje të gjelbër.

Në analizën e infrastrukturës është zhvilluar një kuadër për vendimmarrjen për asetet infrastrukturore me jetëgjatësi të gjatë pavarësisht nga pasiguritë e kushteve klimaterike në të ardhmen. Modelet e motit kanë ndikim mbi besueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve infrastrukturore, ndërsa ndryshimet klimaterike po i përkeqësojnë këto efekte. Pasiguria për klimën në të ardhmen shtron sfidën e marrjes së vendimeve të duhura për infrastrukturën, e cila shpesh reziston gjatë dhe është e kushtueshme për t'u ndërtuar. Planifikuesit duhet të vendosin nëse do të ndërtojnë sot një infrastrukturë që është më fleksibël, apo do të presin të shohin një herë se çfarë do të ndodhë dhe të shpenzojnë nesër më shumë për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin (ose zëvendësimin). Përderisa nuk është e përbalueshme që sot të ndërtohet e gjithë infrastruktura fleksibël ndaj ndryshimeve klimaterike të mundshme, përshtatja *ex ante* duhet të bëhet kur ka logjikë financiare. Metodologjia për analizën e infrastrukturës ka kombinuar analizat e përfitimit të kostove që janë të sigurta, analiza të vendimeve të mirë-informuara për klimën, dhe vendimmarrjen e shëndetshme. Analiza aplikon qasjen e përfitimit të kostos mbi disa skenarë klimaterikë për identifikimin e opinioneve të shëndetshme dhe më pas për identifikimin të një nëngrupi opsionesh që ka të ngjarë të japin rezultate të kënaqshme lidhur me disa rezultate klimaterike. Për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përparësitë kyçe për përshtatjet klimaterike gjatë dekadës së fundit përfshijnë sistemet urbane të kullimit, ndërtesat shëndetësore dhe arsimore dhe ndërtesat bashkiake.

Një vlerësim makroekonomik mbi të gjithë ekonominë vlerëson ndikimin mbi rritjen dhe vënien në jetë të paketave të masave për veprimet klimaterike në të gjithë sektorët dhe ofron këshilla për përparësitë për investimet publike. Modeli dinamik i ekuilibrit të përgjithshëm me sektorë të detajuar ka simuluar skenarët e gjelbër përkundrejt skenarit bazë. Opsionet e përshtatjes (dhe të lehtësimit) janë integruar në model për të bërë të mundur analizimin e rritjes, punësimit, implikimeve fiskale të

kombinimeve të ndryshme të masave të rritjes së gjelbër. Nga vlerësimi rrjedhin këshilla për përparësitë e investimeve publike. Investimet klimaterike kërkojnë kosto që në fillim, por japin përfitime si për kohën aktuale dhe për më vonë. Ndërhyrjet për përshtatje (të cilat mbrojnë produktin e së nesërme nga dëmtimet klimaterike) konstatohet se imponojnë kosto të vogla mbi rritjen dhe punësimin në kuadrin afatshkurtër, pasi rezultatet e sektorit të integrohen në një model të përgjithshëm ekuilibri. Nën skenarin “e gjelbër” të masës klimaterike, masat mesatare përshtatëse në bujqësi dhe në ujë dhe shpenzimet graduale për ndërtimin e infrastrukturës që i përgjigjet ndryshimeve klimaterike do të çonin në një kosto prej rreth 0.1 përqind të PBB-së vjetore. Masat më ambicioze për përshtatjet klimaterike në kuadrin e skenarit të “super gjelbërimit” do të kërkonin investime në sektorin e ujit që arrijnë në një përqind të PBB-së deri në fund të vitit 2015. Së fundi, si masat mesatare dhe ato ambicioze klimaterike premtojnë nxitjen afatmesme deri në afatgjatë të nivelit të PBB-së deri në vitin 2050.

MOMENTI I RËNDËSISHËM II. ANALIZË E MIGRACIONIT NË EJL6

Në vitin 2013, 232 milionë njerëz – 3.2 përqind e popullsisë së botës, kanë jetuar jashtë shtetit të tyre amë, shifër kjo që është rritur me 80 milionë që prej vitit 1990 (Kombet e Bashkuara, 2013). Evropa Lindore dhe Jugore janë ndërmjet dhjetë rajoneve kryesore dërguese siç matet nga përqindja e imigrantëve në totalin e popullsisë burimore rajonale, me migrantët që përbëjnë afërsisht 8-10 përqind të popullsisë aktuale të rajonit. Gjatë viteve 1990 dhe 2000, Evropa Jugore kishte përqindjen më të madhe të emigrantëve ndërmjet të gjithë rajoneve të Evropës dhe brenda rajonit kjo shifër e lartë udhëhoq kryesisht nga shtetet e EJL6-ës.

Një e katërta e popullsisë aktuale e shteteve të EJL6-ës jeton jashtë shteteve të tyre amë. Në vitet 1990, përqindja e emigrantëve nga shtetet e EJL6-ës ishte dy herë më e madhe sesa e pjesës tjetër të shteteve të Evropës Jugore, dhe mesatarisht pesë herë më e lartë sesa ajo e pjesës tjetër të botës (Tabela SII-1). Gjatë dy dekadave të fundit, shtetet e EJL6-ës përjetuan një rritje të madhe të emigracionit. Aktualisht mesatarisht 4.9 milionë njerëz nga shtetet e EJL6-ës numërohen si migrantë në një shtet tjetër, shifër e cila përlllogaritet në një të katërtën e popullsisë rezidente.


Tabela SII.1: Përqindja e stokut të migrantëve në popullsinë e rajonit burimor

Burimi	1990	2000	2010	2013
Shtetet e EJL6-ës	13.2%	22.7%	24.2%	25.4%
Pjesa tjetër e Evropës Jugore	7.0%	6.9%	5.7%	6.0%
Pjesa tjetër e botës	2.7%	2.6%	3.0%	3.0%

Burimi: Vlerësim mbështetur në Stokun Ndërkombëtar të Migrantëve të Kombeve të Bashkuara (rishikimi i 2013-ës)

Karakteristikat e migrantëve

Figura SII-1: Shpërndarja e moshës së emigrantëve në shtetet e OECD-së krahasuar me vendin e burimit, 2005



Burimi: Shpërndarja e moshës e emigrantëve: baza e të dhënave e OECD DIOC 2005/06; shpërndarja e moshës së popullsisë në shtetin burimor: baza e të

Migrantët kanë tendencë të jenë në moshë pune, duke e ulur përmasën e krahut të punës në shtetet e tyre amë. Përqindja e grupmoshës 25-64 vjeç është më

dhënave Barro and Lee (2013) (Shqipëria dhe Serbia), baza e të dhënave (Lutz et al. 2007) (IRJ e Maqedonisë), WDI 2013 (Bosnja dhe Hercegovina)³¹

e madhe ndërmjet emigrantëve, ndërsa individët në grupmoshën 65 ose më shumë vjeç përbëjnë një pjesë goxha më të madhe të popullsisë rezidente sesa emigrantët (Figura SII-1). Kjo vjen si pasojë e kombinimit të gjasave më të larta për migracion të popullsisë më të re, tendencës në rritje të migracionit gjatë dekadave të fundit dhe rritjes së kthimit të migrantëve pas daljes në pension, ku këta të fundit mund të përbëjnë sfida fiskale për vendet e tyre.

Disa shtete të EJL6-ës duket se vuajnë më shumë nga “rrjedhja e trurit” sesa të tjerat.

- Mesatarisht emigrantët shqiptarë duket se janë më mirë të arsimuar sesa popullsia rezidente. Në të gjitha grupmoshat, përqindja e emigrantëve me arsim të lartë është më e lartë se për rezidentët shqiptarë. Hendeku arsimor është edhe më i madh për arsimin e lartë, çfarë do të thotë që një përqindje jo përpjesëtimore e shqiptarëve me aftësi të larta kanë tendencë të emigrojnë (Figura SII-2).
- Në Bosnjë dhe Hercegovinë provat për rrjedhjen e trurit janë të kufizuara. Në të gjitha grupmoshat, të gjithë përqindjet e individëve pa arsim, me arsim fillor ose të mesëm të papërfunduar janë më të larta për emigrantët sesa për banorët vendas në Bosnje dhe Hercegovinë. Duket se veçanërisht individët me arsim të mesëm kanë më pak të ngjarë të emigrojnë. Nga ana tjetër, individët me ca arsim të lartë janë shumë të nënperfaqësuar në popullsinë që jeton në shtetet e OECD-së (Figura SII-3).
- Po ashtu, nivelet arsimore të emigrantëve të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë janë më të ulëta sesa nivelet arsimore të popullsisë që jeton brenda vendit (Figura SII-4).
- Nivelet arsimore të emigrantëve serbë nuk dallojnë shumë nga nivelet arsimore të popullsisë rezidente. Përfundimi i arsimit të mesëm duket se është pak më i shpeshtë ndërmjet serbëve që jetojnë jashtë shteti (Figura SII-5).

Figura SII-2: Arsimi i emigrantëve dhe popullsia në shtetin burimor në vitin 2005, Shqipëria

Figura SII-3: Arsimi i emigrantëve dhe popullsia në shtetin burimor në vitin 2005, Bosnja dhe Hercegovina³²

³¹ Për Bosnjën dhe Hercegovinën të dhënat në dispozicion nuk lejojnë bërjen e dallimit ndërmjet të dy kategorive të moshave 15-24 dhe 25-64 në popullsinë që jeton brenda vendit. Të dyja kategoritë kombinohen në një (15-64).

³² Për shkak të mungesës së të dhënave të duhura, Figura 3 (Bosnja dhe Hercegovina) ka dy mangësi. Së pari, arsimit i tre grupmoshave të emigrantëve krahasohet me arsimin e krahut të përgjithshëm të punës (moshat 15+) në popullsi. Për këtë arsye, të tria kolonat që i përkasin popullsisë në vend janë të barabarta. Së dyti, të dhënat për arsimin në shtetin e burimit i referohen vitit 2009, ndërsa të dhënat për migrantët i referohen periudhës 2005/06.





Figura SII-4: Arsimi i emigrantëve dhe popullsia në shtetin burimor në vitin 2005, IRJ të Maqedonisë





Figura SII-5: Arsimi i emigrantëve dhe popullsia në shtetin burimor në vitin 2005, Serbi




Burimi: Vlerësime bazuar në strukturat e mëposhtme të bazave të të dhënave: Arsिमimi i emigrantëve: baza e të dhënave e OECD DIOC 2005/06; shpërndarja e moshës së popullsisë në shtetin burimor: baza e të dhënave Barro and Lee (2013) (Shqipëria dhe Serbia), baza e të dhënave (Lutz et al. 2007) (IRJ e Maqedonisë), WDI 2013 (Bosnja dhe Hercegovina)

KUTIA S-II.I. Rrjedhje e trurit mjekësor?

“Rrjedhja e trurit mjekësor” po prek disa shtete të EJL6-ës. Rrjedhja e trurit mjekësor përkufizohet si përqindja e mjekëve të trajnuar në një vend dhe që punojnë jashtë shteti dhe mund të përdoret për të përafëruar modelin e migracionit me aftësi të lartë. Me vlera nën mesataren botërore, Shqipëria dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë japin shumë pak prova për rrjedhjen e trurit mjekësor (Figura SII-6). Në Serbi, rrjedhja e trurit mjekësor u rrit shumë në fillim të viteve 2000, duke arritur një nivel prej afërsisht dy herë sa mesatarja botërore. Bosnja dhe Hercegovina tregon vlera të qëndrueshme në rritje dhe mbi mesatare për rrjedhjen e trurit mjekësor.

Figura SII-6: Përqindja e mjekëve që janë të trajnuar në vend dhe punojnë jashtë shteti: Shtetet e EJL6-ës, 1991-2004



Burimi: Docquier dhe Bhargava (2007)

Profesionet e emigrantëve


Nga 28 deri në 45 përqind e emigrantëve me aftësi të larta në shtetet e OECD-së punojnë në profesione që nuk kërkojnë aftësi specifike ose në punë krahu. Në Shqipëri, mospërkimi i aftësive me punët që bëjnë emigrantët duket se është në nivel të lartë. Një e katërta e emigrantëve me arsim të lartë punojnë në punë krahu, ndërsa 20 përqind të tjerë në profesione që nuk kërkojnë aftësi specifike. Në anën tjetër të medaljes, më shumë se 50 përqind e emigrantëve serbë me arsim të lartë punojnë në profesione të mirëfillta dhe 20 përqind në profesione të industrisë së shërbimeve.³³

Ndikimi mbi strukturën demografike në shtetet dërguese

Popullsia e Bosnjës, Shqipërisë dhe Serbisë po tkurret. Në periudhën nga 2005-a deri në 2010-ën, vlerat e ulëta ose negative të rritjes natyrore të popullsisë (lindjet e gjalla për 1000 vetë minus vdekjet për 1000 vetë për të njëjtën periudhë) dhe nivelet negative neto të migracionit kanë shkaktuar rënien e popullsisë në Bosnjë, Shqipëri dhe Serbi. Vetëm në Malin e Zi dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë rrija natyrore ka qenë mjaftueshmërisht e lartë për të kompensuar emigracionin (Figura SII-7 dhe Figura SII-8).


Popullsia pritet të tkurret në të gjitha shtetet e EJL6-ës. Sipas parashikimeve të Popullsisë së Kombeve të Bashkuara, (2012) popullsia e rajonit parashikohet të ulet më shumë në të ardhmen. Shqipëria, ku niveli i rritjes mendohet të qëndrojë në një nivel relativisht të lartë dhe ku ndryshimi natyror pritet të kthehet negativisht vetëm në vitin 2040, është vendi i vetëm në rajon ku popullsia projektohet të rritet deri në vitin 2035. Mendohet për një ndryshim natyror në ulje dhe rënie të migracionit.

Figura SII-7: Ndryshimi i popullsisë për shkak të rritjes natyrore dhe migracionit neto, 2005-10 (shtetet e renditura sipas ndryshimit të popullsisë)



Burimi: Perspektiva e Popullsisë Botërore, Kombet e Bashkuara (2012)

Figura SII-8: Ndryshimi i popullsisë për shkak të rritjes natyrore dhe migracionit neto, 2005-30 (shtetet e renditura sipas ndryshimit të popullsisë)



Burimi: Perspektiva e Popullsisë Botërore, Kombet e Bashkuara (2012)


... dhe çfarë ndodh nëse emigrantët kthehen në EJL6?

Kthimi i emigrantëve në shtetet e EJL6-ës do të çonte në rritjen e popullsisë në moshë pune dhe disa shtete do të përfitonin nga nxitja e aftësive. Figurat SII-9 dhe SII-10 tregojnë se çfarë do t'i ndodhte

³³ Shifrat mbështeten tek baza e të dhënave e OECD DIOC (2005/06). Përkthimi i kodeve të profesioneve të ISCO-88-ës mbështetet tek përkufizimi i profesioneve nga OECD-ja (2002).


strukturës demografike të popullsisë në vendet burimore në Shqipëri dhe Serbi në rast se do të ktheheshin emigrantët e këtyre vendeve nga shtetet e OECD-së. Duke supozuar se vendimi i një individi për arsimim nuk është i varur nga vendimi pasues për migracionin, grafiket ilustronë strukturën e popullsisë sipas gjinisë, grupeve të gjera të moshë dhe arsimit, në skenarin hipotetik se nuk ka emigrim në dekadat e fundit. Të dyja vendet rezultojnë të kenë humbur më shumë burra sesa gra për shkak të migracionit, dhe se burrat që kanë emigruar kanë tendencë të jenë më mirë të arsimuar sesa gratë. Popullsia shqiptare do të jetë goxha më e lartë në kushtet e mungesës së migracionit, ndërsa një përqindje e madhe e individëve të mirë-arsimuar do ta zgjerojë popullsinë në moshë pune, duke sjellë kapitalin e tyre njerëzor. Për Serbinë, ndikimi i situatës hipotetike të kthimit të emigrantëve do të kishte efekt më të vogël.

Figura SII-9: Popullsia meshkuj (në të majtë) dhe femra (në të djathtë) sipas grupmoshave: vendi burimor dhe emigrantët në OECD, Shqipëri 2005



Burimi: baza e të dhënave e OECD DIOC 2005/06; shpërndarja e moshës dhe arsimit në popullsinë e shtetit burimor: baza e të dhënave Barro dhe Lee (2013)

Figura SII-10: Popullsia meshkuj (në të majtë) dhe femra (në të djathtë) sipas grupmoshave: vendi burimor dhe emigrantët në OECD, Serbi 2005



Burimi: baza e të dhënave e OECD DIOC 2005/06; shpërndarja e moshës dhe arsimit në popullsinë e shtetit burimor: baza e të dhënave Barro dhe Lee (2013)

Shtojca: Treguesit makroekonomikë

Tabela AI. 1: EJL6: Tregues dhe Parashikime të Përzgjedhura Ekonomike, 2012-14

	2013	2014 ^e	2015 ^f
Rritja reale e PBB-së (në përqindje)			
Shqipëria	1.4	2.1	3.0
Bosnja dhe Hercegovina	2.5	0.4	1.5
Kosova	3.4	2.5	3.0
Maqedonia, IRJ	2.7	3.3	3.5
Mali i Zi	3.3	1.5	3.4
Serbia	2.6	-2.0	-0.5
EJL6	2.5	0.2	1.3
Deficiti fiskal (përqindje e PBB-së)			
Shqipëria	4.9	5.7	4.8
Bosnja dhe Hercegovina	1.9	4.5	2.7
Kosova	2.9	2.3	2.0
Maqedonia, IRJ	3.9	3.9	3.4
Mali i Zi	3.3	0.7	5.3
Serbia	5.6	7.9	5.6
EJL6	3.8	4.2	4.0
Borxhi publik me garanci (përqindje e PBB-së)			
Shqipëria	70.0	70.9	70.6
Bosnja dhe Hercegovina	46.9	50.2	43.8
Kosova	9.3	10.8	11.5
Maqedonia, IRJ	40.5	46.6	49.4
Mali i Zi	67.5	66.5	72.7
Serbia	61.4	68.6	75.4
EJL6	49.3	52.3	53.9
Inflacioni i çmimit të konsumit (përqindje, periudha mesatare)			
Shqipëria	1.9	2.1	3.0
Bosnja dhe Hercegovina	-0.1	-1.0	1.5
Kosova	1.8	0.6	1.1
Maqedonia, IRJ	2.8	0.3	1.1
Mali i Zi	2.2	-0.2	2.0
Serbia	7.7	2.1	2.7
EJL6	4.2	1.1	2.2
Niveli i papunësisë (në përqindje)			
Shqipëria	17.1	17.2	16.5
Bosnja dhe Hercegovina	27.5	27.5	27.0
Kosova	30.0		
Maqedonia, IRJ	29.0	27.9	
Mali i Zi	19.5	19.4	18.9
Serbia	22.1	19.6	19.0
EJL6	23.5		

Deficiti i llogarive korrente (përqindje e PBB-së)


Shqipëria	10.6	13.9	11.8
Bosnja dhe Hercegovina	5.4	9.7	8.6
Kosova	6.4	8.6	6.8
Maqedonia, IRJ	1.8	1.0	4.0
Mali i Zi	14.6	15.3	16.3
Serbia	6.1	6.1	4.7
EJL6	6.5	7.8	7.0

Borxhi i jashtëm (përqindje e PBB-së)

Shqipëria	34.3	36.7	42.0
Bosnja dhe Hercegovina	50.8	54.6	54.2
Kosova	6.5	7.0	6.0
Maqedonia, IRJ	64.0	71.3	70.4
Mali i Zi	119.8	114.7	127.4
Serbia	78.3	77.0	75.0
EJL6	59.0	60.2	62.5


Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave, Ministrinë e Financave, Bankat Qëndrore dhe parashikimet e Bankës Botërore.

Figura AI. 1: PBB-ja reale: Ndryshimi i përqindjes që prej pikut përpara krizës




Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore dhe të mbështetura në të dhënat e zyrave kombëtare të statistikave.

Figura AI. 2: Parashikimet e rritjes reale të PBB-së për vitin 2015




Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore dhe të mbështetura në të dhënat e zyrave kombëtare të statistikave.

Figura AI. 3: Niveli i papunësisë



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore dhe vlerësime mbështetur në të dhënat e zyrave të statistikave.


Figura AI. 4: Bilanci fiskal




Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore dhe mbështetur në të dhënat e Ministrisë së Financave.

Figura AI. 5: Borxhi publik

Estimated public debt and guarantees in 2014, percent of GDP




Percent of GDP




Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore dhe të mbështetura në të dhënat e Ministrisë së Financave.

Figura AI. 6: Rritja e eksportit




Burimi: Vlerërimet e stafit të Bankës Botërore dhe të Bankave Qendrore.

Figura AI. 7: Rritja e importit




Burimi: Vlerërimet e stafit të Bankës Botërore dhe të Bankave Qendrore.

Figura AI. 8: Bilanci i llogarive korrente





Burimi: Vlerërimet e stafit të Bankës Botërore dhe të Bankave Qendrore.

Figura AI. 9: Huatë e këqija



Burimi: Vlerërimet e stafit të Bankës Botërore dhe të Bankave Qendrore.

Figura AI. 10: Lehtësia e të Bërit Biznes



Burimi: Treguesit e Të Bërit Biznes të Bankës Botërore (2015).